



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 696 Akti

Nr. 808 Vendimi
Tiranë, më 11.10.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 9.10.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Gëzim Veizi**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoj relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoj subjektin e rivlerësimit, vëzhguesen ndërkombëtare, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Gëzim Veizi, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Gëzim Veizi ka ushtruar fillimisht detyrën e oficerit të policisë gjyqësore (OPGJ në vijim) pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë për periudhën mars 1999 – shkurt 2000, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Skrapar për periudhën shkurt 2000 – janar 2004 dhe pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për periudhën janar 2004 – maj 2013. Duke filluar nga maji i vitit 2013 e në vijim ushtron funksionin e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, subjekti i rivlerësimit Gëzim Veizi i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
3. Subjekti i rivlerësimit u shortua me shortin e datës 15.12.2020 dhe iu nënshtrua procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli (kryesuese), Valbona Sanxhaktari (anëtare) dhe Olsi Komici (relator), ndërsa si vëzhgues ndërkombëtar u caktua znj. Elka Ermenkova.
4. Me vendimin e datës 21.1.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, bazuar në nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim vlerësimin e subjektit të rivlerësimit Gëzim Veizi bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; rivlerësimi i aftësive profesionale.
5. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike¹, ku iu komunikua përbërja e trupit gjykues dhe iu kërkua deklarimi i konfliktit të interesit. Subjekti² nuk deklaroi nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues.
6. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Grupi i Punës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.
7. Relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm,

¹ Subjekti u njoftua në datën 21.1.2021 me anë të postës elektronike me *email*.

² Subjekti i rivlerësimit, në datën 17.2.2021, njoftoi Komisionin me anë të postës elektronike.

me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

8. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Gëzim Veizi, si dhe njoftimin e tij për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

9. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 20.9.2024³ mbi rezultatet e hetimit, si dhe mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht zhvilluar nga Komisioni, duke i lënë afat deri në datën 3.10.2024. Subjekti, brenda afatit të lënë nga Komisioni, ka dërguar me postë elektronike (*email*) shpjegimet dhe provat përkatëse.

10. Subjekti i rivlerësimit, në datën 3.10.2024, u ftua në seancën dëgjimore, e cila u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 9.10.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare. Në këtë seancë, subjekti u paraqit personalisht dhe parashtoi shpjegimet e tij dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Z. Gëzim Veizi ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës, Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja⁴, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Gëzim Veizi, i cili është subjekt deklarues pranë këtij institucioni që prej vitit 2003, me nr. indeksi ***, duke konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*

³ Komunikimet ndërmjet Komisionit dhe subjektit të rivlerësimit janë bërë me rrugë elektronike, me *email*.

⁴ Raporti nr. *** prot., datë 28.8.2019, i ILDKPKI-së.

- nuk ka kryer fshehje pasurie;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

14. Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

15. Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe informacionet e marra nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i janë njoftuar rezultatet e hetimit mbi asetet e deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, si vijon:

❖ Mbi asetet e deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë *Vetting*

Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit

1. Apartament me sip. 110.6 m² (87.3 m² funksionale), blerë në vitin 2006 me çmimin 61,000 euro, ndodhur në rrugën “****”, me pjesë takuese 100% dhe burim krijimi: (a) 20,000 euro marrë nga shitja e shtëpisë në Elbasan me kontratën nr. ***, datë 12.1.2005; (b) 41,000 euro kredi nga banka ICB me kontratën nr. ***, datë 15.12.2006.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

1.1 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës të vitit 2013 (në vijim DPFD): *“Apartament 110.6 m² (87.3 m² sipërfaqe funksionale), blerë në vitin 2006 me vlerën 61,000 euro (20,000 euro + 41,000 euro kredi nga ICB, me pjesë takuese 100%”*.

1.2 Nga hetimi administrativ rezulton se subjekti ka depozituar kartelën e pasurisë së apartamentit me sip. 87.30 m², ndodhur në z. k. ***, vol. ***, fq. ***, rruga “****”, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë dhe tek kolona “shuma e paguar” është e shënuar shuma 5,000,000 lekë.

1.2.1 Referuar aktmarrëveshjes datë 25.3.2005 lidhur ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe z. Gëzim Veizi, për ndërtimin e apartamentit me sip. 110.6 m² me çmimin 580 euro/m², përcaktohet se z. Veizi do të paguajë 19,000 euro me hartimin e kësaj kontrate dhe 42,000 euro me përfundimin e punimeve e me hartimin e kontratës së shitjes deri në dhjetor të vitit 2005. Vlera e plotë e apartamentit është 61,000 euro.

1.3 Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)⁵ konfirmon të regjistruar në emër të z. Gëzim Veizi pasurinë nr. ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***, përfituar me kontratën e shitjes datë 17.10.2006.

1.3.1 Në dokumentacionin e përcjellë nga ASHK-ja rezulton kontrata e shitblerjes datë 17.10.2006⁶, ku shoqëria “****” sh.p.k. i shet z. Gëzim Veizit apartamentin me sip. 87.3 m² (10.7

⁵ Përgjigjja e ASHK Tirana Jug nr. *** prot., datë 6.2.2024.

⁶ Kontrata e shitjes nr. *** datë 17.10.2006.

m² + 12.6 m² sipërfaqe e përbashkët), ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, me çmimin 5,000,000 lekë⁷, shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

1.4 Komisioni vëren se në aktmarrëveshjen e datës 25.3.2005 përcaktohet sipërfaqja 110.6 m² dhe çmimi 580 euro/m², që i korrespondon vlerës 64,148 euro.

1.5 Komisioni ka administruar edhe përgjigjen e shoqërisë “****” sh.p.k., të datës 23.5.2024, e cila konfirmon se nga verifikimi në regjistrat që disponon shoqëria prej 10 vitesh nuk u gjenden të dhëna për shtetasit e kërkuar.

1.6 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit me shtetasit S. e A. K., si dhe shoqërinë “****” sh.p.k., dhe nga hetimi nuk u konstatua një situatë e tillë⁸.

1.7 Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se ka mospërputhje të çmimit të apartamentit me sip. 110.6 m², pasqyruar në aktmarrëveshjen e datës 25.3.2005, si çmim 580 euro/m², që duke e llogaritur me sipërfaqen 110.6 m² rezulton vlera 64,148 euro dhe jo 61,000 euro.

1.7.1 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar ndër të tjera se referuar aktmarrëveshjes datë 25.3.2005 me shoqërinë “****” sh.p.k., sipërfaqja e përgjithshme është 110.6 m². Pas bisedimeve me shoqërinë përpara nënshkrimit të aktmarrëveshjes, është rënë dakord që sipërfaqja e përgjithshme prej 99.9 m² do të shitej me çmimin 580 euro/m² = 57,942 euro, sipërfaqja e jashtme e shërbimit prej 10.7 m², e cila ishte verandë e pambuluar për efekt fasade, do të shitej me gjysmën e çmimit të shitjes së sipërfaqes tjetër, pra me 290 euro/m² = 3,103 euro. Vlera totale e apartamentit është: 57,942 euro + 3,103 euro = 61,045 euro, e rrumbullakosur në 61,000 euro, vlerë kjo e pasqyruar në aktmarrëveshjen e datës 25.3.2005.

1.8 Për mospërputhjen e vlerës së apartamentit deklaruar në deklaratën *Vetting*, vlera 61,000 euro, pasqyruar në kontratën e shitblerjes 5,000,000 lekë, subjekti ka shpjeguar ndër të tjera se gjatë nënshkrimit të kontratës së shitjes nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur çmimit të shënuar në vlerën 5,000,000 lekë dhe për shkak të mirëbesimit të krijuar ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., e cila përcaktonte paraprakisht ekstremitetet e ndërtimit tek zyra noteriale. Subjekti ka vijuar se pavarësisht çmimit të vendosur në kontratën e shitjes, ai ka deklaruar dhe i qëndron çmimit të blerjes prej 61,000 euro, si dhe burimit të krijimit të deklaruar.

1.9 Komisioni ka analizuar çmimin e blerjes së apartamentit me sip. 110.6 m² (nga të cilat 99.9 m² apartament dhe 10.7 verandë), duke e krahasuar me çmimin referues të EKB-së të përcaktuar për vitin 2005⁹. Nga të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve për vitin 2006, për qytetin e Tiranës, përcaktohet çmimi 77,452 lekë/m². Duke llogaritur sipërfaqen 99.9 m² x 77,452 lekë = 7,737,455 lekë dhe 10.7 m² x 38,726 lekë/m² = 414,368 lekë, në total në vlerën 8,151,823 lekë, ose 64,846 euro¹⁰. Duket se subjekti e ka blerë apartamentin e tij në vlerën 3,846 euro më lirë, ose 5.9% më ulët krahasuar me çmimet referuese të EKB-së, por që është një vlerë jodomethënëse.

⁷ Kjo shumë e konvertuar në euro do të ishte 40,568 euro, duke përdorur kursin e këmbimit 1 euro = 123.25 lekë, Banka e Shqipërisë, datë 17.10.2006.

⁸ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës nr. *** prot., datë 9.5.2024.

⁹ Udhezim nr. 5, datë 23.11.2005 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2005”.

¹⁰ Kursi i këmbimit 1 euro = 125.71 lekë, Banka e Shqipërisë datë 25.3.2005, data e nënshkrimit të kontratës.

1.10 Komisioni ka analizuar burimet e krijimit të kësaj pasurie, fillimisht shumën 20,000 euro, marrë nga shitja e shtëpisë në Elbasan me kontratën nr. ***, datë 12.1.2005.

1.10.1 Subjekti i rivlerësimit në DPFD-në e vitit 2003 e ka deklaruar këtë pasuri me vlerë në milionë lekë “35”, me adresë në Elbasan, me burim: *dhënë nga shteti nga ligji për të pastrehët.*

1.10.2 Ish-ZVRPP Elbasan¹¹ ka konfirmuar se në emër të shtetases P. V. ka qenë regjistruar pasuria e llojit apartament me sip. 68 m², nr. ***, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, z. k. ***, ndodhur në lagjen “****”, që më pas është tjetërsuar në emër të shtetasit D. K..

1.10.3 Nga dokumentacioni i ZVRPP-së rezulton se apartamenti me sip. 73.01 m² është përfitur nga nëna e subjektit, znj. P. V., me kontratën e shitjes datë 21.8.2001, të lidhur me EKB Elbasan, për çmimin 836,717 lekë. Si pjesëtarë të këtij apartamenti janë edhe fëmijët e saj madhorë A., N. dhe Gëzim Veizi.

1.10.4 Me kontratën e datës 3.9.2001¹², pjesëtarët madhorë A. e N. V. ia shesin pjesën e tyre të bashkëpronësisë P. e Gëzim Veizit për çmimin 10,000 lekë (kontratë e depozituar nga subjekti në ILDKPKI, kur është thirrur për t’u pyetur).

1.10.5 Më tej, me kontratën e datës 7.10.2003¹³, shtetasja P. V. i shet pjesën e saj të bashkëpronësisë djalit të saj Gëzim Veizi, në vlerën 100,000 lekë, duke u bërë kështu ky i fundit pronar i vetëm i apartamentit me sip. 73.01 m².

1.10.6 Komisioni, bazuar në kontratën që nëna e tij ka lidhur me EKB-në në vitin 2001, do të konsiderojë në analizën financiare vlerën e parashikuar në këtë kontratë, pra 65,292 lekë.

1.10.7 I pyetur për kontributin e tij për blerjen e këtij apartamenti nga EKB-ja në vitin 2001, subjekti ka shpjeguar se familja e tij ka jetuar në këtë apartament nga viti 1996 dhe pagesat janë kryer sipas kontratës me EKB-në, dhe konkretisht ajo e datës 30.1.1996, ku janë bërë pagesat 31,029 lekë dhe 34,263 lekë. Apartamenti është blerë me kursimet familjare ndër vite dhe ai nuk ka kontribuar në blerjen e tij. Në lidhje me vëllezërit e tij, subjekti ka deklaruar: *“Në vitin 2001, kur është bërë edhe kalimi i pjesëve të vëllezërve tek unë dhe nëna, që të dy vëllezërit kanë qenë rezidentë ku jetonin dhe punonin në Itali. Vëllezërit dhe nëna vinin të jetonin me ditë kur ktheheshin nga Italia, zakonisht në muajin gusht apo periudha të tjera të vitit sipas rastit¹⁴”*. Ndërsa për nënën ka deklaruar: *“Nëna ime është larguar për në Itali në muajin nëntor të vitit 2000, për efekt të kryerjes së procedurave dhe dokumenteve për bashkim familjar me vëllain N. V.. Në vitin 2003, kur është bërë shitja e pjesës takuese të nënës tek unë, nëna jetonte në Itali me vëllain N. V.”*.

1.10.8 Në mbështetje të këtyre deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumente, të cilat pasqyrojnë lejet e qëndrimit të vëllezërve dhe të nënës në Itali¹⁵.

¹¹ Përgjigja e ZVRPP Elbasan nr. *** prot., e ndodhur në dosjen *Vetting*.

¹² Kontrata e shitjes nr. ***, datë 3.9.2001.

¹³ Kontrata e shitjes nr. ***, datë 7.10.2003, kontratë e depozituar nga subjekti në ILDKPKI kur është thirrur për t’u pyetur.

¹⁴ Vëllai N. V. është larguar në Itali në muajin mars të vitit 1991 dhe vëllai A. V. në muajin nëntor të vitit 1997.

¹⁵ Leje qëndrimi për të huaj ***, për N. V., e cila pasqyron datën e hyrjes në Itali; leje qëndrimi për të huaj ***, për A. V., e cila pasqyron datën e hyrjes në shtetin fqinj; leje qëndrimi për të huaj ***, për P. V., e cila pasqyron datën e hyrjes në vendin fqinj. Aktualisht të dy vëllezërit janë shtetas italianë dhe banojnë atje bashkë me familjet e tyre përkatëse.

1.10.9 Duke qenë se vlera e përfituar nga shitja e këtij apartamenti në vitin 2005 ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2006, Komisioni ka verifikuar mundësinë financiare të subjektit për blerjen e tij në vitin 2001 dhe 2003 përkatësisht.

1.10.10 Sipas kësaj analize, rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar këtë apartament. Në këtë analizë janë pasqyruar vetëm vitet 2001¹⁶ dhe 2003¹⁷, pra vitet kur janë kryer pagesat, pa u përfshirë rezultati i viteve të mëparshme, 1999 e në vijim. Në këtë rast, mundësia për kursime kumulative e subjektit për periudhën 1999 – 2003 do të ishte akoma më e lartë¹⁸.

1.10.11 Më pas, me kontratën e shitjes datë 12.1.2005¹⁹, shtetasit Gëzim e B. Veizi ia shesin apartamenti me sip. 68 m² blerësit D. K. për çmimin 1,900,000 lekë, likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale.

1.10.12 Subjekti në datën 11.7.2005²⁰ është pyetur në ILDKPKI për deklarimin e apartamentit 2+1, të ndodhur në Lagjen Nr. *** Elbasan, në DIPP-në e vitit 2003, për vlerën e deklaruar 35 milionë lekë. Për këtë ai ka shpjeguar se vlera 35 milionë është shprehur në lekë të vjetra, e deklaruar çmimi i banesës sipas vlerës së tregut të asaj periudhe kohore.

1.10.13 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit me shtetasin D. K. dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë²¹.

1.10.14 Komisioni ka konstatuar se për apartamentin me sip. 68 m², të ndodhur në Elbasan, vlera e shitjes së tij është deklaruar 20,000 euro në deklaratën *Vetting*, ndërsa në kontratën e shitjes datë 12.1.2005 rezulton çmimi 1,900,000 lekë dhe për këtë i ka kërkuar subjektit shpjegime me pyetësin nr. 2.

1.10.15 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Me anë të kontratës së shitjes datë 12.1.2005 është realizuar shitja e apartamentit 2+1 që kam pasur në pronësi në Elbasan, shtetasit D. K., i martuar me shtetasen A. M.. Në momentin e realizimit të kontratës së shitjes, me blerësin është dakordësuar çmimi i apartamentit ...por të blihej edhe i gjithë mobilimi nga blerësi. Ndërmjet palëve u ra dakord që vlera e blerjes të ishte në shumën 600,000 lekë, vlerë e cila iu shtua çmimit të apartamentit të përcaktuar në kontratën e shitjes, pra çmimi total i apartamentit është 1,900,000 + 600,000 = 2,500,000 lekë. Shuma prej 2,500,000 lekësh është derdhur në llogarinë bankare të bashkëshortes B. V. në Intesa Sanpaolo Bank. Derdhja e kësaj shume është bërë në datën 17.2.2005 nga vëllai i bashkëshortes së blerësit D. K., z. A. M.. Kjo shumë është tërhequr nga banka në datën 29.3.2005 dhe është konvertuar në euro me kursin e këmbimit të kohës, rreth vlerës*

¹⁶ Rezultati i vitit 2001 është balanca pozitive prej 309,288 lekësh, e cila përftohet nga diferenca e të ardhurave të dokumentuara në vlerën 492,580 lekë minus shpenzime jetese për një person sipas standardit të ILDKPKI-së 108,000 lekë minus pasurinë në vlerën 75,292 lekë (e përbërë nga çmimi i blerjes së apartamentit në datën 4.8.2001 prej 65,292 lekësh dhe pagesa për blerjen e pjesës takuese të vëllezërve 10,000 lekë).

¹⁷ Rezultati i vitit 2003 është balanca pozitive prej 67,871 lekësh, e cila përftohet nga diferencën e të ardhurave të dokumentuara në vlerën 535,326 lekë minus shpenzime jetese për një person për periudhën janar – shtator 2003 dhe pas martesës së subjektit në datën 9.10.2003 deri në dhjetor, për 2 persona, në total në vlerën 117,445 lekë minus pasurinë në vlerën 350,000 lekë (e përbërë nga likuiditete *cash* në shumën 250,000 lekë dhe pagesa për blerjen e pjesës takuese të nënës në apartamentin 68m², në vlerën 100,000 lekë).

¹⁸ Mundësia kumulative për kursime e subjektit në fund të vitit 2001 është 756,123 lekë dhe në fund të vitit 2003 është 1,315,967 lekë.

¹⁹ Kontrata nr. ***, datë 12.1.2005.

²⁰ Përgjigja e ILDKPKI -së nr. *** prot., datë 11.3.2021, drejtuar Komisionit.

²¹ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës nr. *** prot., datë 9.5.2024.

20,000 euro, e cila është përdorur si paradhënie në bazë të aktmarrëveshjes së datës 25.3.2005, të lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k.”.

1.10.16 Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të datës 27.5.2024, që deklaron faktin e blerjes së shtëpisë nga shtetasi D. K. bashkë me mobilimin e shtëpisë, që kushtonte 600,000 lekë.

1.10.17 Nga verifikimi i lëvizjes së llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit në Intesa Sanpaolo Bank, Komisioni ka evidentuar veprimet:

a) Kryerja e depozitimit *cash* të shumës 2,490,500 lekë nga shtetasi A. M., në datën 17.2.2005, çka provon që subjekti dhe bashkëshortja e kanë përfituar vlerën 2.5 milionë lekë nga shitja e apartamentit në Elbasan, sikurse ai ka sqaruar në pyetësonin nr. 2.

b) Tërheqja *cash* e shumës 2,450,000 lekë nga shtetasja B. V., në datën 29.3.2005, e cila sipas deklarimeve të subjektit në po këtë pyetësor ka shërbyer për pagesën e këstit të parë tek shoqëria “****” sh.p.k. Ky sqarim i subjektit duket bindës, pasi përputhen shuma dhe koha e tërheqjes së saj me të dhënat përkatëse të përcaktuara në aktmarrëveshjen e datës 25.3.2005.

1.10.18 Sa i takon ligjshmërisë së të ardhurave të përfituara nga shitja e apartamentit në Elbasan, në kontratën e shitblerjes së datës 12.1.2005 është përcaktuar si çmim shitjeje shuma 1,900,000 lekë, mbi të cilën janë paguar edhe detyrimet tatimore²². Pavarësisht se vlera e shitjes së mobilieve prej 600,000 lekësh rezulton të jetë paguar nga blerësit nëpërmjet bankës, pra është e evidentuar që ajo është përfituar fizikisht nga subjekti/bashkëshortja: (i) vlera e mobilieve nuk është përcaktuar në kontratën e shitblerjes datë 12.1.2005; (ii) mbi këtë shumë nuk rezulton të jenë paguar detyrimet tatimore. Për këto arsye, në analizën e burimeve të deklaruara nga subjekti do të konsiderohet si e ardhur e ligjshme nga shitja e apartamentit vlera 1,900,000 lekë dhe jo 2,500,000 lekë.

1.10.19 Nga kjo analizë e burimeve, në këtë fazë të hetimit, rezulton se subjekti ka një mungesë burimesh të ligjshme në kuptim të nenit D të ligjit nr. 84/2016, në vlerën 600,000 lekë, për krijimin e shumës 20,000 euro, të deklaruar prej tij në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP/2013, si një prej burimeve të drejtpërdrejta të deklaruara për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi.

1.11 Komisioni ka analizuar edhe shumën 41,000 euro, të marrë kredi nga banka ICB në datën 15.12.2006. Subjekti ka depozituar kontratën e huas datë 15.12.2006²³, të lidhur ndërmjet NGB Bank dhe shtetasve Gëzim e B. Veizi, për dhënien hua të shumës 41,000 euro, me qëllimin e vetëm përdorimin e huas për të financuar blerjen e një apartamenti ndodhur në rrugën “****”, Tiranë. Me dokumentin bankar të bankës ICB të datës 29.3.2016, konfirmohet shlyerja e plotë e kësaj kredie.

1.11.1 Kjo kredi është deklaruar nga subjekti në DPFD-në e vitit 2013, marrë në vlerën 41,000 euro, me detyrim të pashlyer në shumën 20,193 euro.

1.11.2 Komisioni ka konstatuar se kontrata e shitblerjes datë 17.10.2006 rezulton e lidhur përpara se të merrej kredia me kontratën e datës 15.12.2006 dhe, në këto, kushte, në këtë fazë të hetimit u vlerësua se kredia nuk mund të ketë shërbyer si burim për pagesën e këstit të dytë të apartamentit. Subjektit iu kërkuan shpjegime me pyetësonin nr. 2.

²² Meqenëse apartamenti është regjistruar në emër të blerësit, pagesa e detyrimeve tatimore është konsideruar e mirëqenë.

²³ Kontrata e huas nr. ***, datë 15.12.2006.

1.11.3 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Duke qenë se nuk disponoja në atë kohë shumën prej 41,000 euro për shlyerjen e vlerës së mbetur të apartamentit, ishte rënë dakord me shoqërinë “****” sh.p.k. që kjo shumë do të sigurohej si kredi nga Banka Ndërkombëtare Tregtare (ICB), me ndërmjetësimin e “****” sh.p.k., për shkak të marrëdhënies së veçantë që ajo kishte me këtë bankë, zyrat e së cilës ndodheshin në ambientet e kompleksit ***. Për të realizuar këtë proces, meqenëse unë nuk disponoja asnjë pasuri tjetër të paluajtshme që duhet të vihej si kolateral pranë bankës për përfitimin e kësaj kredie, duhej kryer fillimisht kontrata e shitjes me shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k., me qëllim regjistrimin e apartamentit në emrin tim në hipotekë, me qëllim vënien si kolateral të kësaj pasurie për të garantuar marrjen e shumës prej 41,000 euro në bankë, mënyrë e dakordësuar dhe përdorur në atë kohë nga banka dhe ndërtuesi, me qëllim lënien si kolateral të shtëpisë së blerë. Në këtë moment nuk është kryer asnjë pagesë prej meje për shoqërinë “****” sh.p.k., pasi nuk e disponoja këtë shumë. Pra shuma prej 41,000 euro e përfituar nga kjo kredi ka kaluar direkt në llogarinë e shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k...”*

1.11.4 Union Bank²⁴ i ka përcjellë Komisionit dosjen e plotë të kredisë prej 41,000 euro, e cila përmban: (i) kontratën e kredisë dhe atë hipotekore; (ii) marrëveshjen midis shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. dhe shtetasve Gëzim e B. Veizi, të datës 25.3.2005; (iii) planin e pagesave të kredisë, ku evidentohet se kredia është disbursuar në datën 28.12.2006; (iv) dy mandate bankare, nga të cilat një veprim debitimi i llogarisë së kredisë së z. Veizi, në shumën 41,000 euro, dhe një veprim kreditimi tek shoqëria “****” sh.p.k., i së njëjtës shumë. Të dyja mandatet mbajnë datën 28.12.2006.

1.11.5 Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni konstatohet se: (i) nga plani i shlyerjes së kredisë pranë Bankës Ndërkombëtare Tregtare ICB tregohet që shuma e disbursuar e kredisë është 41,000 euro dhe data e disbursimit është 28.12.2006; (ii) në të njëjtën datë shuma prej 41,000 euro është kaluar në llogarinë e shoqërisë ndërtuese.

1.11.6 Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë paqartësi konsiderohen të mjaftueshme dhe bindëse. Në jo pak raste, kjo ka qenë praktikë e bankave, të cilat bashkëpunonin me firma të ndryshme ndërtimi, duke thjeshtuar procedurat e kredimarrjes. Kur ekzistojnë marrëveshje të tilla, shoqëritë ndërtuese kanë edhe informacionin e plotë për ecurinë e aplikimit të një kredie, sikurse edhe garancinë e bankës për aprovimin e saj. Pra, midis shoqërisë ndërtuese dhe subjektit është lidhur kontrata në datën 17.10.2005, në të cilën është parashikuar përmbushja e pagesës, por që në fakt ajo ka qenë një formalitet për regjistrimin e pronës në emër të subjektit për të vijuar me lëvrimin e kredisë dhe garantimin e kthimit të saj, sikurse e shpjegon subjekti.

1.11.7 Për efekt të analizës financiare për blerjen e apartamentit, u konsideruan si më poshtë:

- i) vlera e apartamentit 61,000 euro;
- ii) pagesa e kështit të parë prej 20,000 euro, datë 29.3.2005²⁵, sipas kontratës së sipërmarrjes;
- iii) pagesa e kështit të dytë prej 41,000 euro, datë 28.12.2006, e cila është data e kalimit të shumës së kredisë nga llogaria bankare e subjektit në atë të shoqërisë “****” sh.p.k.

²⁴ Union Bank me shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2024.

²⁵ Sikurse është evidentuar tërheqja e shumës 20,000 euro, e përcaktuar në aktmarrëveshjen e datës 25.3.2005.

Analiza financiare e burimeve të përdorura për blerjen e apartamentit

1.11.8 Pavarësisht se nga analiza direkte e burimeve të deklaruara nga subjekti, burime të cilat kanë shërbyer për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi, sikurse konkluduar në çështjen 1.10.18 më sipër, Komisioni kreu edhe një analizë më të plotë dhe të gjerë financiare, duke përdorur metodologjinë kumulative për periudhën 1999 – 2006 (periudhë në të cilën subjekti nuk ka qenë në detyrën e prokurorit), kur është blerë ky apartament, nga e cila rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të kryer pagesën e këtij apartamenti²⁶, duke përdorur shumën prej 1,900,000 lekësh nga shitja e apartamentit në Elbasan, kursime të akumuluar ndërr vite nga paga e tij, si dhe kredinë bankare në shumën 41,000 euro.

1.11.9 Komisioni në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ngarkoi subjektin barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit në lidhje me konstatimet e mëposhtme:

i) Konstatohet se ka mospërputhje të vlerës së apartamentit me sip. 110 m², pasi në deklaratën Vetting subjekti ka deklaruar vlerën 61,000 euro, vlerë e pasqyruar edhe në aktmarrëveshjen e datës 25.3.2005, ndërsa në kontratën e shitblerjes të datës 17.10.2006 është pasqyruar vlera 5,000,000 lekë.

ii) Konstatohet mospërputhje e vlerës së shitjes së apartamentit në Elbasan, pasi në DIPP-në e vitit 2003 subjekti deklaroi vlerën në milion lekë “35”; në kontratën e shitblerjes datë 12.1.2005 pasqyrohet vlera 1,900,000 lekë, e konvertuar me kursin ditor të kësaj date²⁷ i korrespondon vlerës 14,735 euro dhe në deklaratën Vetting deklaroi vlerën 20,000 euro.

iii) Nga analiza e drejtpërdrejtë të burimeve ka rezultuar se subjekti ka mungesë fondesh në vlerën 600,000 lekë, të deklaruara se janë përfituar prej tij nga shitja e këtij apartamenti.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.11.10 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore ka shpjeguar:

➤ Në lidhje me diferencën në çmimin e blerjes së apartamentit, ashtu si edhe në pyetësorë, subjekti ka shpjeguar se për këtë konstatim është vënë në dijeni nga Komisioni, pasi nënshkrimi i kontratës së shitblerjes ka qenë akt formal, të cilit subjekti nuk i kishte kushtuar shumë rëndësi. Ndër të tjera, subjekti thekson se vlera e blerjes së apartamentit është 61,000 euro, të cilën e ka deklaruar në DPFD-në e vitit 2013, si dhe deklaratën Vetting, dhe për këtë shumë janë deklaruar edhe burimet përkatëse të ligjshme.

➤ Në lidhje me vlerën e shitjes së apartamentit në Elbasan, subjekti ka shpjeguar se shuma e përfituar në bankë nga shitja e apartamentit ka qenë 20,000 euro dhe që i është referuar vlerës së shitjes së apartamentit dhe arkëtimit të vlerës së shitjes së mobilieve. Pavarësisht se në deklaratën Vetting nuk janë specifikuar të ardhurat nga shitja e apartamentit dhe shitja e mobilieve, subjekti i është referuar shumës 20,000 euro, pothuajse sa vlera që bashkëshortja ka tërhequr nga llogaria

²⁶ Nga një analizë financiare gjithëpërfshirëse e subjektit për periudhën 1.3.1999 deri në fund të vitit 2006, ka rezultuar në balancë pozitive kumulative prej 2,942,436 lekësh, e cila e cila përfshihet nga diferenca e të ardhurave të dokumentuara në vlerën 7,258,188 lekë minus shpenzime jetese sipas përbërjes familjare për periudhën, në vlerën 1,638,859 lekë minus pasurinë neto në vlerën 2,676,893 lekë (e përbërë nga pasuria bruto në vlerën 7,701,033 lekë dhe detyrimet 5,024,140 lekë, që është kredia 41,000 euro e marrë nga ICB Bank.

²⁷ Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për datën 12.1.2005, ku 1 euro = 128.94 lekë.

bankare, pra shuma 2,490,500 lekë, të derdhura nga blerësi i apartamentit D. K. në ISP Bank (nëpërmjet A. M., vëllai i A. M. bashkëshortja e D. K.). Për më tepër, nga analiza financiare e Komisionit për vitet 2003 e 2004, ai dhe bashkëshortja kanë pasur teprica kursimesh kumulative, që tregojnë se ata kanë pasur mundësi të investojnë në blerjen e mobilieve në shumën 600,000 lekë, sa ç'është vlera e shitjes së tyre të pretenduar.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

1.11.11 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme:

➤ Në lidhje me mospërputhjen e çmimit të blerjes së apartamentit, subjekti duhej të kishte treguar kujdesin e duhur në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe të kishte verifikuar vlerën e shënuar në kontratë. Gjithsesi, kjo pakujdesi duket se ka qenë e paqëllimshme, pasi nuk favorizonte subjektin në deklarimin e një çmimi më të ulët në kontratën e shitjes, ndërkohë që subjekti nuk ka qenë në cilësinë e shitësit që të mendohej se do përfitonte duke paguar tatimin mbi të ardhurat në një vlerë më të vogël se vlera reale. Ka qenë vetë subjekti në DPFD-në e vitit 2013 dhe në deklaratën *Vetting* ai që ka deklaruar vlerën reale të blerjes së këtij apartamenti prej 61,000 euro, duke deklaruar gjithashtu edhe burimet e të ardhurave për shumën e paguar 61,000 euro, në përputhje të plotë me ligjin nr. 9049/2003.

➤ Në lidhje me vlerën e blerjes së apartamentit në Elbasan, vlera e deklaruar nga subjekti në DPFD-në e vitit 2003 është 35 milionë lekë, ndërsa në rubrikën “Burimi i pasurisë” ai ka deklaruar “*Dhënë nga shteti nga ligji për të pastrehët*”. Në këto kushte, vlera e shënuar duket e pakuptimtë dhe të krijon bindjen se subjekti ka deklaruar vlerën që ky apartament do të kishte po të shitej në tregun e lirë në momentin e deklarimit, duke e bërë atë një deklaram të pasaktë, por të paqëllimshëm.

➤ Në lidhje me vlerën e mobilieve prej 600,000 lekësh, si pjesë përbërëse e çmimit të shitjes së apartamentit në Elbasan, Komisioni nuk e mori në konsideratë këtë vlerë si burim të ligjshëm, pasi ajo nuk është parashikuar në kontratën e shitblerjes së apartamentit datë 12.1.2005 dhe nuk është deklaruar veçmas as në deklaratën *Vetting*, por u deklarua vetëm gjatë procesit të rivlerësimit.

1.11.12 Sidoqoftë, pavarësisht se nga analiza direkte e burimeve të deklaruara nga subjekti, burime të cilat kanë shërbyer për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi, ka rezultuar pamjaftueshmëri të ardhurash të ligjshme pikërisht në vlerën e shitjes së mobilieve, bazuar në një analizë më të plotë dhe gjithëpërfshirëse financiare, Komisioni nuk mund të mos i konsiderojë të ardhurat dhe/ose kursimet e tjera të subjektit nga pagat e tij, të krijuara deri në momentin e blerjes së këtij apartamenti. Kjo qasje e ka bazën në disa argumente, si: (i) shitja e apartamentit që ka shërbyer si burim është bërë në vitin 2005, shumë vite përpara se subjekti të emërohej në detyrë si prokuror; (ii) pavarësisht se vlera e shitjes në kontratë është përcaktuar 1,900,000 lekë, është një fakt i pakundërshtueshëm që në llogarinë bankare të bashkëshortes së tij është kredituar nga shitësi vlera prej 2,490,500 lekësh, e cila përbën vlerën reale të përfituar nga subjekti; (iii) legjitimiteti i diferencës prej 600,000 lekësh është vërtet i cënueshëm, por legjitimiteti i të ardhurave dhe i kursimeve progresive nga paga e subjektit ndër vite është i vërtetuar e, për rrjedhojë, i pakontestueshëm.

1.11.13 Për këto arsye, në analizën e tij përfundimtare, Komisioni vlerëson se analiza financiare, e cila duhet të shërbejë për të mbështetur arritjen në konkluzionin përfundimtar mbi mundësinë financiare të subjektit për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi, është analiza gjithëpërfshirëse kumulative për periudhën 1 mars 1991 deri në momentin e blerjes së apartamentit, duke e vlerësuar atë si më të logjikshme dhe më pranë realitetit financiar.

Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar saktë pasurinë apartament me sip. 110 m², si dhe kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme financiare për ta blerë këtë pasuri, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

2. Apartament me sip. 127.27 m², blerë në vitin 2016 me çmimin 100,000 euro, ndodhur në rrugën “****”, me pjesë takuese 100%, me burim krijimi: (a) 15,000 euro marrë hua nga shtetasi O. A. sipas aktit noterial nr. ***, datë 2.4.2016; (b) 5,000 euro të konvertuara nga tërheqja e 1,000,000 lekë nga depozita e TB në emër të bashkëshortes B. V.; (c) 11,000,000 lekë e konvertuar në 80,000 euro, marrë kredi nga Raiffeisen Bank sipas kontratës së kredisë nr. ***, datë 16.5.2016.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

2.1 Subjekti e ka deklaruar blerjen e këtij apartamenti në DIPP-në e vitit 2016, me adresë rruga “****”, në shumën 100,000 euro, si dhe burimet e krimit të saj.

2.2 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se nga noteri M. T.²⁸ është administruar kontrata e premtim-shitjes datë 7.4.2016²⁹, lidhur ndërmjet shitësit L. H. dhe blerësve Gëzim e B. Veizi, për apartamentin me sip. 127.27 m², me çmimin 100,000 euro, i cili do të likuidohet në dy këste: (i) shumën prej 20,000 euro blerësi do ta depozitojë në llogarinë bankare të noteres në ditën e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes; (ii) diferenca prej 80,000 euro do të depozitohet në llogarinë bankare të noteres në Raiffeisen Bank me lëvrimin e kredisë nga pala blerëse, por jo më vonë se 15.5.2016.

2.3 Bashkë me deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes (me kusht kreditimi) të datës 2.5.2016³⁰, ku rezulton se apartamenti me sip. 127.27³¹ m², i ndodhur në rrugën “****”, është blerë nga Gëzim e B. Veizi shtetases L. H., me çmimin 100,000 euro, i cili do të likuidohet me dy këste: (i) kësti i parë prej 20,000 euro është derdhur në llogarinë e noteres në Raiffeisen Bank; (ii) kësti i dytë prej 80,000 euro do t’i paguhet shitësit nga kredia që blerësi do të marrë në Raiffeisen Bank deri në datën 30.5.2016.

2.4 Kësaj kontrate i bashkëngjitet mandati i Raiffeisen Bank datë 3.5.2016, ku rezulton shuma e derdhur prej 20,000 euro nga z. Gëzim Veizi në llogari të noteres M. T., si dhe dokumenti bankar i Raiffeisen Bank datë 19.5.2016, ku Gëzim Veizi transferon në llogari të noteres shumën 11,000,000 lekë. Gjithashtu, sipas mandatit të Raiffeisen Bank datë 20.5.2016, rezulton se nga llogaria e noteres M. T. është transferuar shuma 99,999.60 euro në llogari të shtetases L. H..

²⁸ Përgjigjja e noteres M. T. me shkresën e datës 25.4.2024.

²⁹ Kontrata premtim shitjeje nr. ***, datë 7.4.2016.

³⁰ Kontrata nr. ***, datë 2.5.2016.

³¹ Nr. pas. ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***.

2.5 Pas regjistrimit në ZVRPP është lëshuar certifikata e pronësisë datë 9.5.2016 e apartamentit me sip. 127.27 m², në pronësi të shtetasve Gëzim e B. Veizi.

2.6 Komisioni ka analizuar çmimin e blerjes së apartamentit me sip. 127.7 m², duke e krahasuar me çmimin referues të EKB-së, të përcaktuar për vitin 2016³². Udhëzimi referon se nga të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve për vitin 2016, për qytetin e Tiranës, zonën ***, ku përfshihet edhe rruga “****”, përcakton çmimin 107,000 lekë/m². Duke llogaritur sipërfaqen 127.27 m² x 107,000 lekë = 13,617,890 lekë, e konvertuar në 98,500 euro³³, duket se subjekti e ka blerë apartamentin pothuaj sa çmimi i referencës.

2.7 ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug³⁴ konfirmon pasurinë nr. ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***, në emër të shtetasve Gëzim e B. Veizi.

2.8 Komisioni ka analizuar edhe burimin e shumës 100,000 euro, dhe fillimisht shumën 15,000 euro, marrë hua shtetasit O. A.. Subjekti ka depozituar aktin noterial të datës 2.4.2016³⁵ të nënshkruar nga shtetasit O. A. dhe Gëzim Veizi, në të cilin deklarohet se Gëzim Veizi detyrohet t’i paguajë O. A. shumën 15,000 euro, të cilën e ka marrë në datën 29.3.2016, sipas mandatit të lëshuar nga Raiffeisen Bank, dhe shumën 2,000 euro *cash* jashtë zyrës noteriale. Data e kthimit të huas do jetë 2.4.2025, nëpërmjet bankës ose me deklaratë noteriale.

2.9 Bashkëngjitur deklaratës është edhe dokumenti bankar i Raiffeisen Bank datë 29.3.2016, ku shtetasi O. A. ka transferuar në llogari të z. Gëzim Veizi shumën 13,000 euro.

2.10 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit me shtetasit O. A. dhe L. H. dhe nga hetimi nuk u konstatua ndonjë situatë e tillë.

2.11 Subjekti në pyetësin nr. 1 për shtetasin O. A. ka shpjeguar se ka njohje të vjetër familjare (shokë fëmijërie).

2.12 Për burimin e të ardhurave për shumën 15,000 euro, të huadhënësit O. A., të referuara prej tij, subjekti ka shpjeguar se janë: (a) të ardhurat nga paga për periudhën 2013 – 2015; (b) të ardhurat nga paga pranë shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, të cilat në vitin 2013 kanë qenë 500,000 lekë bruto/muaj dhe në vitet 2014 dhe 2015 kanë qenë 130,000 lekë bruto/muaj, vërtetuar me shkresën nr. *** prot., datë 31.12.2020, të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor³⁶.

2.13 Subjekti ka shpjeguar gjithashtu se deri tani nga huaja e marrë ka shlyer shumën 5,000 euro në datën 3.10.2019 nga llogaria e qirasë në emër të bashkëshortes; ka shlyer shumën 1,500 euro në datën 4.3.2020 nga llogaria e qirasë së bashkëshortes dhe shumën 186,000 lekë në datën 5.3.2020 nga llogaria e kursimit të bashkëshortes në Raiffeisen Bank, në total rreth 8,000 euro. Gjithashtu, subjekti ka depozituar dokumentacion provues për të ardhurat e shtetasit O. A.³⁷.

³² Udhëzimi nr. 3, datë 28.12.2016 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2016”.

³³ Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë i datës 3.5.2016, ku 1 euro = 138.30 lekë.

³⁴ Përgjigja e ASHK Tirana Jug nr. *** prot., datë 6.2.2024.

³⁵ Akti noterial nr. ***, datë 2.4.2016.

³⁶ O. A. ka qenë ortak në shoqërinë “****” sh.p.k. me NIPT ***, duke zotëruar 50% të kuotave të shoqërisë. Me shkresën nr. *** prot., datë 31.12.2020, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan konfirmon se ky subjekt ka shpërndarë dividend në vitin 2015 me deklaratën e tatimit në burim të muajit korrik 2015. Shuma e dividendit të shpërndarë është në shumën 10,317,408 lekë dhe tatimi i paguar është 1,547,611 lekë.

³⁷ Formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat i shoqërisë “****” sh.p.k. për periudhën tatimore korrik 2015, ku pasqyrohet fitimi 10,317,408 lekë dhe tatimi i paguar 1,547,611 lekë (ky është bilanci i të ardhurave të vitit 2014);

2.14 Qendra Kombëtare e Biznesit (në vijim QKB)³⁸ konfirmon se shtetasi O. T. A. figuron i regjistruar si administrator dhe ortak i shoqërisë “****” sh.p.k. me NUIS ***, me status “aktiv”, ndërkohë që rezulton edhe administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, me status “aktiv”.

2.15 Komisioni verifikoi të ardhurat personale nga puna të shtetasit O. A., për periudhën 2013 deri në fund të marsit 2016, të cilat janë paraqitur si në tabelën më poshtë:

Përshkrimi	2013	2014	2015	Mars 2016	Total lek	Total euro
Të ardhurat nga paga në	4.860.895	1.242.611	1.240.344	310.086	7.653.936	55.226³⁹

2.16 Nga totali i këtyre të ardhurave rezultoi se ato e tejkalojnë disa herë shumën e dhënë hua tek subjekti. Kështu, shuma prej 15,000 euro u përfshi si burim i ligjshëm në analizën financiare të subjektit, për blerjen e apartamentit në Tiranë.

2.17 *Diferenca prej 5.000 euro të konvertuara nga tërheqja e 1,000,000 lekë nga depozita e TB e bashkëshortes B. V.*

2.18 Nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit dhe bashkëshortes, përkatësisht në Raiffeisen Bank dhe Tirana Bank, është evidentuar se:

2.18.1 Në datën 1.4.2016, në llogarinë e subjektit tek Raiffeisen Bank është depozituar shuma 7,000 euro, me përshkrimin “B. H. V. derdhje”. Në të njëjtën datë, nga llogaria e shtetases B. V. në Tirana Bank është tërhequr shuma 1,030,740 lekë, e cila e ka origjinën nga shumat e depozituara nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor gjatë vitit 2014. Pra, kjo shumë ka burim të ligjshëm.

2.18.2 Si pasojë e konvertimit të kësaj shume janë përfutur 7,425 euro⁴⁰, të cilat janë depozituar në llogarinë e subjektit në Raiffeisen Bank.

2.18.3 Duket se e gjithë shuma prej 7,000 euro, e depozituar tek Raiffeisen Bank, vjen nga të ardhurat e bashkëshortes, të cilat ndodhen në llogarinë e saj në Tirana Bank. Sidoqoftë, kjo nuk mund të përjashtojë marrjen dhe posedimin e shumës 2,000 euro, e cila është pjesë e huas (e dhënë *cash*) nga shtetasi O. A..

2.18.4 Shuma prej 7,000 euro i bashkohet shumës 13,000 euro, e cila u depozitua nga shtetasi O. A. dhe ndodhet në llogarinë e subjektit në Raiffeisen Bank, duke u përfutur kështu shuma prej 20,000 euro. Kjo shumë, në datën 3.5.2016, është transferuar në llogarinë e noteres M. T., person fizik, me NIPT ***, me përshkrimin “Pagesë në bazë të kontratës së shitblerjes nr. **** rep., nr. **** kol., kësti i parë Gëzim Q. Veizi”.

2.19 Shuma 11,000,000 lekë, konvertuar në 80,000 euro, marrë kredi në Raiffeisen Bank. Ka rezultuar se subjekti bashkë me deklaratën *Vetting* ka depozituar kontratën e kredisë bankare të

Shkresa e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor nr. *** prot., datë 31.12.2020, ku pasqyrohen të dhënat e pagës bruto/neto për z. O. A. nga punësimi pranë shoqërisë “****” sh.p.k., për periudhën 2012 – 2017, ku rezulton se ai është paguar me pagë nga 50,000 lekë, 500,000 lekë dhe 130,000 lekë; Shkresa e DRT Elbasan nr. *** prot., datë 31.12.2020, që konfirmon se për subjektin “****” sh.p.k., me administrator O. A., për muajin korrik 2015 tatim fitimi i shpërndarë nga subjekti është në shumën 10,317,408 lekë.

³⁸ QKB me nr. *** prot., datë 15.5.2024.

³⁹ Shuma e të ardhurave është shprehur në euro për t’u krahasuar me atë të kredisë, e cila është në euro. Kursi i këmbimit është kursi mesatar i viteve 2013 – 2016, i marrë nga Banka e Shqipërisë, 31 dhjetor i çdo viti përkatës.

⁴⁰ Kursi i këmbimit 1 euro = 138.82 lekë, Banka e Shqipërisë, datë 1.4.2016.

datës 16.5.2016⁴¹, me kredithënës Raiffeisen Bank dhe kredimarrës Gëzim e B. Veizi, të vlerës 11,000,000 lekë, me qëllim blerje shtëpie.

2.19.1 Në këtë kontratë përcaktohet se shuma e aprovuar e kësaj kredie do të transferohet në llogari të noteres M. T., sipas kontratës së shitblerjes me kusht kreditimi nr. ***, datë 2.5.2016. Në nenin 6 të kontratës përcaktohet se sigurimi i kredisë do të bëhet nëpërmjet vënies si garanci të apartamentit me sip. 127.27 m², ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

2.19.2 Nga lëvizja e llogarisë bankare e subjektit në Raiffeisen Bank është evidentuar se në datën 19.5.2016 është disbursuar kredia hipotekore, në shumën 11,000,000 lekë. Në të njëjtën datë, kjo kredi ka kaluar në llogarinë e noteres M. T., person fizik, me përshkrimin “Kalim për blerje apartamenti, sipas kontratës së shitblerjes datë ***, nr. *** rep., nr. *** kol., me nr. pasurie ***, z. k. ****”. Ky është edhe kësti i dytë, përafërsisht 80,000 euro, i cili përmbush detyrimin e subjektit për pagesën e apartamentit me sip. 127.27 m², ndodhur në kompleksin ***.

Analiza financiare

2.20 Komisioni ka verifikuar mundësinë e subjektit për pagesën e shumës 20,000 euro, në datën 3.5.2016, sipas së cilës ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi për pagesën e kështit të parë të apartamentit. Gjithashtu, e njëjta gjë vlen edhe për kështin e dytë, të paguar në datën 19.5.2016 me kredinë e marrë në Raiffeisen Bank.

2.20.1 Kështu, duke bërë një analizë direkte të burimeve, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e apartamentit objekt shqyrtimi. Por, edhe nga një analizë e plotë e periudhës⁴², arrihet në të njëjtin konkluzion.

Në konkluzion të sa më sipër, ka rezultuar se subjekti ka bërë deklaram të saktë të pasurisë apartament me sip. 127.27 m². Subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të kryer pagesën e dy kështeve të apartamentit objekt shqyrtimi, në total në vlerën 100,000 euro.

3. Automjet tip “Daimler Chrysler”, blerë me çmimin 2,500 euro në vitin 2015⁴³, me pjesë takuese 100%, me burim krijimi: të ardhurat e marra nga shitja e automjetit tip “Golf” me kontratën nr. ***, datë 16.1.2015.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

3.1 Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Daimler Chrysler”, në datën 16.1.2015 në shumën 2,500 euro, me pjesë takuese 100% (deklaruar gabimisht në vitin 2014).

⁴¹ Kontrata e kredisë bankare.

⁴² Komisioni ka kryer analizën financiare të subjektit për periudhën 1 janar deri më 3.5.2016, i cili është momenti i pagesës së kështit të parë 20,000 euro, për apartamentin, nga e cila ka rezultuar një balancë pozitive prej 555,735 lekësh. Ky rezultat është përftuar si diferencë e të ardhurave nga paga e subjektit dhe bashkëshortes së tij në vlerën 941,430 lekë; shpenzime 507,471 lekë dhe pasuri neto në vlerë negative 121,777 lekë (si diferencë e pasurisë bruto 1,668,296 dhe detyrimeve 1,790,073 për shkak të huas së marrë nga z. O. A.)

⁴³ Blerë me kontratën nr. ***, datë 16.1.2015.

3.2 DPSHTRR-ja⁴⁴ konfirmon automjetin tip “Daimler Chrysler ****”, vit prodhimi 2006, me targë ***, regjistruar në emër të z. Gëzim Veizi, të përfituar nga kontrata e datës 16.1.2015⁴⁵ blerë nga shitësi E. G. me çmimin 2,500 euro dhe likuiduar jashtë zyrës noteriale.

3.2.1 Nga dokumentacioni i DPSHTRR-së rezulton se shtetasi E. G. e kishte blerë këtë automjet me kontratën e datës 15.9.2011, me çmimin 20,000 euro nga shtetasi A. T., ndërkohë që vetë shtetasi A. T. e kishte blerë automjetin në datën 8.6.2009 nga shtetasi I. H., me çmimin 990,000 lekë. Shtetasi I. H. e kishte blerë automjetin në Gjermani në datën 25.5.2009 me çmimin 17,479 euro dhe i kishte paguar doganë në datën 26.5.2009, në vlerën 677,487 lekë. Po në datën 16.1.2015, subjekti ka shitur një automjet tip “Golf”, prodhim i vitit 1999, në vlerën 2,500 euro dhe ka deklaruar se kjo shumë ka shërbyer për blerjen e automjetit tip “Daimler Chrysler”.

3.2.2 Komisioni vëren se pas 4 vite përdorimi shtetasi E. G. ia ka shitur me 2,500 euro, ndërkohë që më parë vetë ky shtetas e kishte blerë 20,000 euro. Por Komisioni vëren se ky automjet është blerë dhe shitur me vlera të ndryshme nga persona të ndryshëm, vlera këto konfuze dhe kontradiktore dhe që nuk i korrespondojnë një logjike financiare të mirëfilltë dhe, për këtë arsye, nuk mund të penalizohet subjekti për këtë luhatshmëri çmimesh të aplikuara në transaksione për këtë automjet.

Komisioni ka analizuar automjetin tip “Golf 4”, ku të ardhurat nga shitja e tij shërbyen si burim krijimi.

3.3 Për të verifikuar ligjshmërinë e burimit të mjetit tip “Daimler Chrysler”, Komisioni ka analizuar blerjen e automjetit tip “Golf 4” në vitin 2014, në shumën 3,000 euro dhe shitjen e tij në datën 16.1.2015, në shumën 2,500 euro.

3.4 Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Golf” në shumën 3,000 euro, me burim kursimet nga paga, ndërsa në DIPP-në e vitit 2015 deklaroi “shitjen e tij në vlerën 2,500 euro”.

3.5 DPSHTRR-ja⁴⁶ konfirmon automjetin tip “Volkswagen Golf”, që ka qenë në pronësi të z. Gëzim Veizi, të cilin e kishte blerë me kontratën e datës 26.11.2013⁴⁷ nga shtetasit A. e I. Sh., për çmimin 3,000 euro. Nga dokumentacioni në dosje rezulton se vetë shtetasit I. e A. Sh.ia kishin blerë këtë automjet me kontratën e datës 27.9.2007⁴⁸ shtetasit D. T. (përfaqësuar me prokurë nga A. H.), me çmimin 250,000 lekë. Ndërsa me kontratën e datës 16.1.2015⁴⁹ z. Gëzim Veizi i shet blerësit S. T. këtë automjet me çmimin 2,500 euro.

3.6 Komisioni ka analizuar burimin e krijimit të automjetit tip “Golf 4”, deklaruar “nga pagat”. Nga analiza para fillimit të detyrës si prokuror, subjekti ka rezultuar me teprica pozitive mjete shmonetare, të cilat mund të kishin shërbyer për blerjen e këtij mjeti në datën 26.11.2013. Por, në DPFD-në e cila është plotësuar dhe dorëzuar në datën 28.6.2013, subjekti nuk ka deklaruar asnjë

⁴⁴ Përgjigjja e DPSHTRR-së nr. **** prot., datë 8.5.2024, drejtuar Komisionit.

⁴⁵ Kontrata e shitjes nr. ****, datë 15.9.2011.

⁴⁶ Përgjigjja e DPSHTRR-së nr. **** prot., datë 26.2.2021, drejtuar Komisionit.

⁴⁷ Kontrata e shitblerjes nr. ****, datë 26.11.2013.

⁴⁸ Kontrata e shitblerjes nr. ****, datë 27.9.2007, me shitës D. T. dhe blerës I. e A. Sh..

⁴⁹ Kontrata nr. ****, datë 16.1.2015.

gjendje *cash*, çka tregon se ai nuk ka trashëguar kursime vlerash monetare, nga periudha përpara detyrës.

3.7 Në këto kushte, Komisioni ka kryer analizën financiare të subjektit për periudhën 28.5.2013 – 26.11.2013, për të verifikuar mundësinë kursyese nga pagat, të subjektit dhe bashkëshortes, nga data e emërimit në detyrë e deri në datën e blerjes së automjetit. Sipas kësaj analize, rezultoi pamjaftueshmëri të ardhurash të ligjshme për shkak të një balance negative në vlerën -73,134 lekë⁵⁰.

3.8 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit me shtetasit A. e I. Sh. dhe E. G., dhe nga hetimi nuk rezultoi një situatë e tillë.

3.9 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ngarkoi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit në lidhje me konstatimin për automjetin tip “Golf 4”, si vijon: *“Subjekti dhe familja e tij nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e mjetit Golf për shkak të një rezultati negativ prej -73,134 lekësh”*.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i çështjes nga Komisioni

3.10 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore ka kundërshtuar analizën financiare të Komisionit, duke parashtruar se:

3.10.1 Komisioni në përlllogaritjet e tij për periudhën 28.5.2013 – 26.11.2013 ka konsideruar si shpenzime jetike ato vjetoret për 4 persona, të cilat janë në vlerën 564,096 lekë. Ndërkohë që periudha e analizuar është 6 muaj dhe, për këtë arsye, edhe shpenzimet duhet të përlllogariten për të njëjtën periudhë, pretendim i cili u mor në konsideratë nga Komisioni.

Pas rikryerjes së analizës financiare për blerjen e automjetit tip “Golf” në datën 26.11.2013, subjekti ka rezultuar me një balancë pozitive në vlerën 128,328 lekë⁵¹.

4. Tokë me sip. 507 m², kthyer trashëgimtarëve të shpronësuar M. V. (K.) të njohur me vendimin nr. *, datë 26.9.1995, të KKKP-së të ish-pronarëve të Bashkisë Kavajë. Pjesa takuese: 11.11%.**

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

4.1 Subjekti i rivlerësimit në DPFD-në e vitit 2013 e ka deklaruar këtë pasuri: *“Truall në qytetin e Kavajës me sip. 507 m², trashëguar, njohur dhe kthyer fizikisht me vendim të AKKP-së nr. ***, datë 15.5.2013, me pjesë takuese 1/16”*.

4.2 Subjekti bashkë me deklaratën *Vetting* ka depozituar vendimin nr. ***, datë 17.5.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, të dëshmisë së trashëgimisë së trashëgimlënësit M. V., ku përcakton trashëgimtarët e radhës së parë: (1) Q. V. (ndërruar jetë në vitin 1974) dhe P., A., N. e Gëzim Veizi; (2) N. V.; (3) Q. V.; (4) N. V..

⁵⁰ Të ardhura nga paga e dy bashkëshortëve për periudhën, në vlerën 1,350,387 lekë; shpenzime 682,192 lekë; pasuri neto 741,329 lekë (si diferencë e pasurisë bruto 457,388 lekë dhe i detyrimeve në vlerën negative -283,941 lekë, për shkak të shlyerjes së kësteve të kredisë së marrë në ICB Bank).

⁵¹ Të ardhurat nga paga e dy bashkëshortëve dhe pasuria për periudhën nuk kanë ndryshuar dhe janë në vlerën 1,350,387 lekë dhe 741,329 lekë përkatësisht; shpenzime 480,729 lekë.

4.3 Me vendimin nr. ***, datë 15.5.2013, të AKKP Tiranë, bazuar në kërkesën e trashëgimtarit Gëzim Veizi, u vendos kthimi fizik i sipërfaqes së lirë prej 507 m² (550 m² - 43 m²), ndodhur në qytetin e Kavajës, trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar M. V..

4.4 ASHK Kavajë⁵² nuk konfirmon regjistrimin e kësaj pasurie.

4.5 Subjekti u pyet me pyetësin nr. 2 për statusin aktual të kësaj prone dhe përse nuk është ende e regjistruar, i cili ka shpjeguar se vendimi nr. ***, datë 15.5.2013, është ankuar në Gjykatë nga Avokatura e Shtetit, e cila ka kërkuar anulimin e tij. Aktualisht çështja është në gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me status “pezulluar”, sipas vendimit nr. ***, datë 5.10.2022.

Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me këtë pasuri.

PERSONI I LIDHUR ME SUBJEKTIN, BASHKËSHORTJA B. V.

5. Të ardhura në shumën 2,700,714 lekë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. *, datë 31.3.2014, për shkak të zgjidhjes së marrëdhënies së punës me *** sh.a.**

5.1 Këto të ardhura janë depozituar në llogarinë bankare në Tirana Bank, në shumën prej 1,000,000 lekësh, mbyllur si depozitë me afat (tërhequr në prill të vitit 2016), pjesa e mbetur në llogari rrjedhëse e përdorur për shlyerjen e kredisë në ICB (e mbyllur në mars 2016).

5.2 Të ardhurat nga vendimi gjyqësor⁵³ janë deklaruar nga bashkëshortja e subjektit, B. V., në DIPP-në e vitit 2014.

Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me këto të ardhura.

KONSTATIME TË TJERA

6. Në lidhje me likuiditetet

6.1 Në DPFD-në e vitit 2003, u evidentua se në rubrikën “Likuiditete” subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë shumën 02.5 (në milion lekë), me burim kursime.

6.2 Subjekti është pyetur në ILDKPKI për të saktësuar gjendjen *cash*. Në procesverbalin e datës 11.7.2005⁵⁴, në përgjigje të pyetjes nr. 2, subjekti ka deklaruar se: “*Vlera e deklaruar nga ana ime është një gabim shifror, pasi vlera reale që disponoja ka qenë 250,000 lekë*”.

6.3 Për sa më lart, Komisioni ka konsideruar në analizën financiare për vitin 2003 gjendje *cash* prej 250,000 lekësh, e cila është pjesë e likuiditeteve, e konsideruar si e shpenzuar për nevoja familjare në vitet në vijim.

6.4 Në lidhje me një *overdraft*-in (OVD) të subjektit në Credins Bank, është evidentuar se ai e ka përfituar atë në vitin 2010 dhe e ka shlyer në vitin 2014. Shuma 149,200 lekë është përfshirë si shpenzim në analizën financiare të vitit 2014.

⁵² Përgjigja e ASHK Kavaje nr. *** prot., datë 31.1.2024.

⁵³ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 31.3.2014, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 29.9.2015.

⁵⁴ Ky procesverbal është përcjellë në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 21.3.2021.

7. Në lidhje me disa depozitime në llogarinë e kredisë në ICB Bank

7.1 Nga lëvizjet e llogarisë në ICB Bank, u evidentuan disa depozitime në llogarinë e kredisë së subjektit gjatë viteve 2007 dhe 2008, por më të spikaturit ishin ai i datës 29.6.2007, me përshkrimin “Nga “****” sh.p.k. për pagesë betoni/G. Veizi” dhe ai i datës 5.12.2008, me përshkrimin “**** punime hekuri Fat. ***, datë 27.11.2008”.

7.2 Subjekti u pyet mbi marrëdhënien e tij me shoqërinë “****” sh.p.k., i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 3 ka sqaruar se: *“Këto janë gabime në përshkrim të bëra nga punonjësi i bankës, i cili ka kryer veprimet për regjistrimin e derdhjes së kështit të kredisë. Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se nuk kam asnjë lloj njohjeje apo lidhje me shoqërinë “****” sh.p.k.”.*

7.3 Subjekti sqaron se në llogarinë e kredisë janë derdhur kështet e kredisë prej tij ose bashkëshortes, të cilat, sikurse vërtetohet nga *statementi*, janë pagesa periodike mujore të kështit të kredisë, në shumën 465 euro/muaj. Për të mbështetur deklarin e tij, subjekti ka paraqitur pranë Komisionit katër veprime depozitimi të nxjerra nga ekstrakti i llogarisë në Union Bank (ish-ICB Bank), ku paguhen kështet e kredisë, veprime në të cilat ai pretendon të ketë gabime në përshkrim⁵⁵.

7.4 Sqarimet e subjektit duken bindëse, pasi: (i) nga leximi i veprimeve bankare të paraqitura prej tij dallohet një përshkrim “Depozitim page etj.”, i cili nuk mund të jetë i saktë, pasi asnjë nga bashkëshortët nuk e merr pagën në ICB Bank e, për më tepër, kalimet e pagave kanë përshkrime automatike, të cilat ndryshojnë nga ky përshkrim i datës 7.10.2008; (ii) në depozitim të datës 30.6.2008 përshkruhet “Kalim fondesh BOA”, i cili është akronim i Bankës së Shqipërisë⁵⁶; (iii) llogaria është e destinuar për t’i shërbyer kredisë dhe depozitimet e kryera janë në vlera të përafërta me kështin mujor që paguan subjekti. Nga kjo llogari duket edhe debitimi automatik që bëhet çdo muaj nga banka kur realizohet pagimi i kështeve të kredisë.

7.5 Për sa më sipër, Komisioni vlerësoi se deklarinet e subjektit në lidhje me këto depozitime janë të sakta dhe se ato kanë të bëjnë me depozitime të subjektit për të paguar kështet e kredisë bankare dhe jo depozitime të të tretëve apo për llogari të të tretëve në këtë llogari.

Veprime të kryera nëpërmjet kartave të kreditit dhe debitit të subjektit dhe bashkëshortes

8. Nga hetimi administrativ u evidentua se subjekti dhe bashkëshortja e tij përdorin karta debiti dhe krediti të Raiffeisen Bank dhe Tirana Bank, për të kryer pagesa të ndryshme ose tërheqje nga ATM jashtë Shqipërisë dhe terminale pagesash, në ato ditë/periudha kur subjekti dhe bashkëshortja kanë udhëtuar jashtë shtetit. Për të arritur në një konkluzion mbi natyrën e këtyre transaksioneve bankare, u nxor një ekstrakt i secilës prej këtyre llogarive, sikurse paraqitur në vijim.

8.1 Veprime të subjektit me kartë debiti dhe krediti në Raiffeisen Bank

8.1.1 Nga lëvizjet e llogarive të subjektit në Raiffeisen Bank, u evidentuan disa veprime të kryera jashtë Shqipërisë me kartën e debitit të lidhur me llogarinë e tij të pagës dhe kartën e kreditit Master Card të parapaguar, veprime të cilat janë treguar në tabelën e mëposhtme:

⁵⁵ Në datën 27.2.2007 depozituar shuma 500 euro, me përshkrimin “Cash deposit punime karpeterie “****” sh.p.k.”; në datën 2.10.2007, depozituar shuma 475 euro, me përshkrimin “Cash deposit KOM për ****”; në datën 30.6.2008 depozituar shuma 465 euro, me përshkrimin “Cash deposit Kalim fondesh BOA”; në datën 7.10.2008 depozituar shuma 520 euro, me përshkrimin “Cash deposit Paga Shtator 08”.

⁵⁶ Bank of Albania (BOA).

Veprime me kartat në RZB Bank	<i>Nga data 28.5.2013</i>	2014	2015	2016	Total në lek
Veprime në POS (në lek) ⁵⁷	14.355	295.387	526.354	63.042	899.138
Tërheqje nga ATM (në lek) ⁵⁸			63.495	64.335	127.830
Pagesa me MC (kartë krediti)				122.605	122.605
Total shpenzime	14.355	295.387	589.849	249.982	1.149.573

✓ Gjatë vitit 2013, pas emërimit në detyrë të subjektit, u evidentua një veprim në terminal POS⁵⁹ në datën 22.12.2013, në vlerën 14,355 lekë, i kryer në Maqedoninë e Veriut.

✓ Gjatë vitit 2014, u vërejtën 6 veprime në POS në vlerën totale 295,387 lekë, të kryera në Maqedoninë e Veriut.

✓ Gjatë vitit 2015, u vërejtën 9 veprime në POS në vlerën 526,354 lekë dhe 1 tërheqje nga ATM⁶⁰ në vlerën 63,495 lekë, gjithsej 589,849 lekë. Nga këto veprime, 5 janë kryer në Mal të Zi dhe 5 të tjera në Maqedoninë e Veriut.

✓ Gjatë vitit 2016, u vërejtën 3 veprime në POS, në vlerën 185,646.93 lekë, nga të cilat një i kryer në USA dhe dy në Maqedoninë e Veriut⁶¹; një tërheqje nga ATM në vlerën 64,335 lekë, i kryer në USA. Gjithsej 249,982 lekë.

Gjithsej veprimet e kryera me kartat e Raiffeisen Bank janë në vlerën 1,149,573 lekë.

8.1.2 Komisioni vërejtë se në pyetësin standard, në kapitullin e deklarimeve për udhëtimet jashtë shtetit, subjekti ka deklaruar se ai udhëton në mënyrë periodike në Maqedoninë e Veriut për arsye shëndetësore/terapi, dhe konkretisht në ***, e cila është një qendër me ujëra termale e ndodhur në një vend të izoluar në natyrë. Një nga Pikat e Shitjes (POS), ku ai kryen veprime me kartën e tij, përkon të jetë një hotel rreth 5 km larg nga ujërat termale, i cila nga verifikimi në *Google Maps* është pika e vetme më e afërt me vendin ku subjekti qëndron. Nga 21 veprimet e mësipërme të evidentuara, 9 janë të kryera në këtë hotel.

8.1.3 Bazuar në ekstraktin e llogarisë bankare, në veprimin e debitimit evidentohet emërtimi i një biznesi ose hoteli dhe në veprimin pasues, për çdo transaksion të subjektit, evidentohet përshkrimi “Komision për veprim POS jashtë”. Nisur nga këto përshkrime të bankës, veprimet u konsideruan nga Komisioni si blerje produkte dhe shërbimesh, të kryera nga llogaria e pagës së subjektit, të cilat nuk mund të jenë pjesë e shpenzimeve të jetesës ose atyre të udhëtimit sipas të dhënave nga sistemi TIMS, shpenzime të cilat janë në vlera bazike. Për efekt të analizës financiare, në këtë fazë të hetimit, ato u konsideruan si vijon:

⁵⁷ 3 veprime POS, në datën 9.10.2015, në Maqedoninë e Veriut, nga përshkrimi i subjektit tregtar duken të jenë blerje mallrash konsumi.

⁵⁸ Gjatë vitit 2014 janë kryer 3 tërheqje dhe gjatë vitit 2015 janë kryer 8 tërheqje.

⁵⁹ *Point Of Sale*, në shqip Pikë Shitje, janë makinat të cilat përdoren nga subjekte tregtare dhe iu mundësojnë blerësve të tyre blerje mallrash apo tërheqje *cash*, me karta bankare, debiti dhe krediti.

⁶⁰ *Automated Teller Machine*, në shqip bankomat, të cilat janë makinat ku kryhen tërheqje *cash* jashtë arkave të bankës, duke përdorur kartat e debitit ose kreditit.

⁶¹ Nga këto 3 veprime në POS, një në USA dhe një në Maqedoninë e Veriut, janë kryer nga Master Card, e cila është e parapaguar. Pra, subjekti depoziton para në të dhe mund të shpenzojë aq sa ka balancën. Kartat e parapaguara përdoren vetëm për blerje mallrash dhe shërbimesh dhe jo për tërheqje *cash*.

8.1.3.1 Veprimet në pikat e shitjes POS u njohën nga Komisioni si blerje produktesh e shërbimesh dhe u përfshinë në analizën financiare, si shpenzime ekstra.

8.1.3.2 Tërheqjet nga ATM jashtë shtetit⁶² u konsideruan si nevojë e subjektit për të kryer shpenzime gjatë udhëtimeve të tij jashtë. Kështu që: (i) shuma 400.90 euro⁶³ u konsiderua si e shpenzuar gjatë qëndrimit në USA; (ii) shuma 505.47 euro⁶⁴ u konsiderua si e shpenzuar gjatë qëndrimit në Maqedoni. Të dyja shumat u përfshinë tek shpenzimet ekstra.

8.1.3.3 Sa më sipër, veprimet POS dhe/ose tërheqjet në ATM jashtë Shqipërisë, së bashku me komisionet e bankës, që lidhen me përdorimin e kartave, janë në vlerën **1,167,783 lekë**⁶⁵.

Kjo vlerë, deri në këtë fazë të hetimit, u përfshi në analizën financiare të viteve përkatëse në një zë të veçantë tek shpenzimet, përtej atyre të jetesës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

8.1.4 Subjekti e ka kundërshtuar këtë mënyrë llogaritje nga ana e Komisionit, duke pretenduar se: *“Veprimet e evidentuara nga Komisioni të kryera në pikat e shitjes POS nuk janë blerje, por tërheqje dhe se ai i ka kryer ato gjatë qëndrimit të tij për terapi shëndetësore, në Maqedoninë e Veriut”*. Subjekti ka sjellë në vëmendje dokumentet e përcjella me pyetësin standard, që provojnë vizitat e tij mjekësore⁶⁶. Ai ishte i detyruar të kryente tërheqje cash në POS, pasi qendra shëndetësore ndodhet në një vend të izoluar pa bankomate dhe se pika më e afërt që e ofronte këtë shërbim ishte një hotel. Subjekti e mbështet këtë pretendim bazuar në përshkrimin e veprimeve bankare të kryera, në të cilat, sipas tij, nuk evidentohet asnjë pagesë e cila të jetë destinuar për një përfitues të tretë. Në këtë rast do të ishte identifikuar përfituesi/tregtari i kësaj pagese, ndërkohë që nga leximi i lëvizjes së llogarisë bankare identifikohet vetëm vendndodhja e pikës së shitjes POS, ku janë tërhequr shumat monetare.

8.1.5 Për të provuar se transaksionet me POS janë tërheqje dhe jo pagesa, subjekti ka udhëtuar në Maqedoninë e Veriut në shtator të vitit 2024 dhe ka kryer dy tërheqje nga POS në shumat respektive prej 18,600 MKD⁶⁷. Ai ka vënë në dispozicion të Komisionit: (a) një video të regjistruar të kësaj procedure⁶⁸; (b) dy fatura të printuara të këtyre veprimeve më shumë 18,600 MKD secila; (c) ekstrakt të llogarisë së tij bankare në Raiffeisen Bank, ku në debi të saj dallohen dy tërheqjet e kryera, të cilat mbajnë përshkrimin “Veprim në POS jashtë ALB”.

⁶² Të dyja këto tërheqje nuk janë përfshirë si shpenzime të udhëtimit TIMS, pra nuk janë shpenzime të dubluara.

⁶³ Tërhequr nga llogaria e pagës me kartë debiti në datën 3.6.2016 nga ATM në ***.

⁶⁴ Tërhequr me kartë krediti Master Card, në datën 29.10.2016, nga ATM në Maqedoninë e Veriut.

⁶⁵ Shpenzimet e kryera nga pikat e shitjes dhe tërheqjet ATM jashtë shtetit në vlerën 1,149,573 dhe komisionet bankare 18,210 lekë.

⁶⁶ Vërtetim nga dr. A. P., i cili vërteton se subjekti për periudhën 2014 – 2015 ka marrë shërbime dhe konsultime në *** për arsye shëndetësore; letër konfirmimi nga hotel R. P., i cili specifikon ditët e qëndrimit të subjektit atje dhe çmimin e paguar 25 euro/natë në një dhomë dyshe.

⁶⁷ Bazuar në kursin në treg të lirë midis dinarit maqedonas dhe euros, shuma 18,600 MKD është afërsisht 300 euro. <https://www.xe.com/currencyconverter/convert/?Amount=1&From=EUR&To=MKD>

⁶⁸ Në videon me gjatësi 1:16 min dallohet se subjekti, i cili shkon në një sportel dhe kërkon tërheqjen e shumës 300 euro; ai jep kartën bankare dhe kartën e identitetit, punonjësja përgjegjëse, pasi kryen verifikimet e saj, kryen transaksionin në POS dhe në fund i numëron dhe i jep subjektit shumën 300 euro dhe faturën e transaksionit.

8.1.6 Për të treguar ekzistencën e këtyre lloj veprimeve, subjekti i referohet vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë⁶⁹ dhe sjell në vëmendje disa statistika të Bankës Qendrore⁷⁰ mbi numrin e tërheqjeve *cash* nga POS, ndër vite, me kartat e bankave që operojnë në tregun shqiptar.

Nga sa më sipër, subjekti konkludon se rezultoni e provuar që veprimet e kryera në pikat e shitjes POS, me kartën e tij jashtë Shqipërisë, janë tërheqje *cash* dhe nuk janë pagesa për palë të treta.

8.1.7 Në parashtrimet e tij, subjekti kundërshton konsiderimin e këtyre tërheqjeve si shpenzime, një metodologji e cila nuk bazohet në ligj dhe fakte, pasi nuk ekziston asnjë dokumentacion ligjor që të tregojë se këto shuma janë të shpenzuara nga ana e tij: *“Të konsiderosh tërheqjet nga llogaria jashtë vendit si shuma të shpenzuara kur nga ana tjetër nuk dokumentohet kryerja e një shpenzimi, në vlerësimin tim nuk qëndron. Sikundër ne kryejmë në mënyrë periodike tërheqje cash në ATM brenda vendit për t’i pasur gjendje dhe për t’i destinuar si shpenzime, ashtu kam vepruar dhe unë në POS jashtë vendit për tërheqjen e shumave monetare të cilat i kam pasur gjendje dhe më kanë shërbyer për përballimin e shpenzimeve të jetesës, për përballimin e hotelit, blerjen e karburantit apo për çdo shpenzime tjetër të nevojshme.”*

8.1.8 Për më tepër, bazuar në lëvizjet e llogarisë së tij bankare, subjekti sjell në vëmendje faktin se veprimet pasardhëse për tërheqje nga ATM brenda vendit kanë një diferencë kohore me tërheqjet e kryera nga POS/ATM jashtë vendit, duke dashur të provojë se shumatat monetare të tërhequra jashtë vendit kanë tepruar dhe ato kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të përditshme të jetesës edhe në Shqipëri kur është kthyer.

8.1.9 Subjekti konkludon se nuk ka asnjë provë apo dokumentacion që të provojë se shumatat monetare të tërhequra jashtë vendit janë shpenzuar dhe kërkon që ato të konsiderohen si çdo tërheqje brenda vendit, pasi kanë shërbyer për përballimin e shpenzimeve gjatë vitit.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

8.1.10 Në lidhje me pretendimin se veprimet në POS nuk janë blerje, por tërheqje *cash*, Komisioni, pasi shqyrtoi me kujdes provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti, vërejtë se:

8.1.11 Sa i takon ofrimin të shërbimit “tërheqje nga POS” nga bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, subjekti ka arritur ta provojë atë me rregulloren dhe statistikat e Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu, nga ana e Komisionit u vizitua faqja zyrtare e Raiffeisen Bank, nga ku rezultoi se edhe sot, në kushtet dhe tarifatat e kësaj banke përshkruhet se ofrohet transaksioni tërheqje *cash* nga POS dhe tarifatat e aplikuar, brenda dhe jashtë vendit.

8.1.12 Sa i takon videos së vënë në dispozicion nga ana e subjektit, ajo vërtet përshkruan një veprim tërheqjeje në POS, jashtë shtetit, por në të nuk dallohet as vendi dhe as koha se kur është kryer veprimi i treguar në të. Sidoqoftë, prej saj dallohet që: (i) ka një komoditet në sjelljen e subjektit, çka tregon se ai është i lirshëm kur e kryen këtë transaksion, i cili duket të jetë i përsëritur

⁶⁹ Vendimi nr. ***, datë 6.2.2008, i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për miratimin e rregullores për instrumentet e pagesave elektronike”, në nenin 17, shkronja “b” përcakton llojin e transaksioneve që kryhen me kartat bankare, të cilat janë “b) pagesa e të mirave dhe shërbimeve, si dhe tërheqje *cash* nga një terminal *** etj.”.

⁷⁰ https://www.bankofalbania.org/rc/doc/aneksi_6_shqip_terminal_q1_2023_24016.xlsx

prej tij; (ii) shuma 300 euro, e cila tërhiqet, është ajo prej 18,600 MKD, e provuar me faturat e veprimit të tërheqjes në Maqedoninë e Veriut dhe njëkohësisht me veprimin e debitimit në ekuivalentin në lek në Raiffeisen Bank, të përcjella nga subjekti, dhe që i përkasin datës 22.9.2024; (iii) kjo datë është pas dërgimit të rezultateve të hetimit, çka vërtet tregon se subjekti ka udhëtuar në Maqedoninë e Veriut enkas për të prodhuar këtë provë të re për Komisionin.

8.1.13 Sa i takon kohës dhe vendndodhjes së terminalit të POS, ku subjekti pretendon se i ka kryer këto veprime, Komisioni e riverifikoi vendndodhjen e banjave termale që subjekti viziton në mënyrë periodike dhe distancën e hotelit nga ku bëhen veprimet në POS, nga ku duket se kjo është pika në distancën më të afërt me banjat termale.

8.1.14 Sa i takon përshkrimit të veprimit të pasqyruar në lëvizjen e llogarisë bankare të subjektit në Raiffeisen Bank, u krye krahasimi i transaksioneve brenda dhe jashtë vendit, nga ATM dhe POS, nga ku rezultoi se: (i) veprimet e debitimit të llogarisë, qoftë në ATM apo POS, kanë të njëjtin kod transaksioni; (ii) dallohen veprimet e tërheqjes në ATM nga ato të kryera në POS nga fjala *ATM + vendndodhje* në përshkrimin e tyre; (iii) nuk ka një diferencim për veprimet e kryera në POS që të mund të identifikojë nëse debitimi i llogarisë është blerje në POS apo tërheqje në POS; në këtë kontekst, mbetet e paqartë nëse në përshkrimin e transaksionit me kartën e subjektit përshkruhet vendndodhja e terminalit apo emri i subjektit tregtar; (iv) subjekti jep shpjegime për tërheqjet në POS nga Gevgelja, ndërkohë që ai ka bërë veprime POS edhe në Shkup, por edhe në Mal të Zi, por pa u shprehur për rrethanat përse këto tërheqje bëhen nga POS dhe jo nga ATM-ja; (v) pas çdo veprimi POS me kartën e debitit ka një tarifë të aplikuar nga banka, përshkrimi i së cilës është “Komision për veprim POS jashtë”, por edhe nga ky përshkrim nuk evidentohet nëse veprimi është blerje/pagesë apo tërheqje në pikën e shitjes; (vi) nëse do të kërkonim të merrnin informacion mbi tarifën e aplikuar nga ana e bankës, ajo varion në varësi të transaksionit që kryhet⁷¹. Pas kërimit në faqen zyrtare të Raiffeisen Bank, u konstatua se nuk ka arkiv për komisionet/tarifat e aplikuar në vitet 2013 – 2016, por gjenden vetëm tarifat aktuale, mbi të cilat nuk mund të gjykojmë, pasi ato janë objekt rishikimi i vazhdueshëm nga ana e bankës/ave të nivelit të dytë.

8.1.15 Sa i takon pretendimit se meqenëse këto veprime janë tërheqje dhe jo pagesa, ato duhen trajtuar si tërheqje vlerash monetare brenda Shqipërisë, Komisioni vlerëson se ky pretendim qëndron, bazuar në: (i) mungesën e provave nëse paratë e tërhequra janë shpenzuar dhe/ose shumat konkrete të shpenzuara jashtë Shqipërisë, përveç atyre të cilat janë përfshirë njëherë në shpenzimet TIMS; (ii) praktika e Komisionit në raste të tjera ka treguar se tërheqjet jashtë vendit janë konsideruar, në parim, njësoj me ato brenda vendit, në rast se nuk është provuar ose nuk ka indicie bindëse për shpenzimin e tyre në destinacione të tjera.

8.1.16 Sa i takon pretendimit se veprimet e tërheqjes jashtë dhe brenda Shqipërisë kanë një diferencë kohore të tillë, çka tregon se subjekti ka teprica *cash* nga shumat e tërhequra jashtë, të cilat i përdor brenda Shqipërisë, u kryen verifikime për tërheqjet e kryera nga subjekti dhe bashkëshortja nga llogaritë përkatëse të pagave⁷², pas kthimit të tyre nga jashtë vendit, për

⁷¹ Të tjera tarifa aplikohen për tërheqje nga ATM, të tjera për blerje në POS dhe të tjera për tërheqje nga POS, të diferencuara këto për brenda dhe jashtë vendit.

⁷² Subjekti e merr pagën në Raiffeisen Bank, ndërsa bashkëshortja në Tirana Bank. Të dyja kanë karta debiti të lidhura me llogaritë përkatëse të pagave.

periudhën dhjetor 2013 deri fund të tetorit 2016. Gjatë kësaj periudhe, u identifikua çdo datë konkrete kur është kryer veprim debitimi nga subjekti dhe/ose bashkëshortja gjatë udhëtimeve të tyre jashtë shtetit, qoftë ky veprim ATM apo POS, meqenëse nga subjekti u pretendua se në këto të fundit ka kryer tërheqje dhe jo blerje. Pra duke konsideruar vetëm për efekt të verifikimit të kësaj situate që çdo veprim i kryer nga të dy bashkëshortët përfaqëson vlerë monetare të tërhequr *cash*.

8.1.17 Nga këto verifikime u konstatua se distanca kohore midis veprimeve të debitimit të llogarive të kryera jashtë me tërheqjet brenda vendit ka qenë:

- nga 1 deri 4 ditë pas kthimit – 5 raste;
- 5 deri 6 ditë pas kthimit – 1 rast;
- nga 11 ditë deri në 3 muaj pas kthimit – 8 raste.

8.1.18 Nga sa më sipër, vërehet se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë një sjellje uniforme sa i takon veprimeve të tërheqjes së parave nga banka, pas kthimit të tyre nga jashtë shtetit. Sidoqoftë, në një hark kohor nga dhjetori 2013 deri në fund të tetorit 2016, konstatohet se rastet më të shumta janë kur subjekti dhe bashkëshortja tërheqin vlera monetare nga bankat brenda vendit me një distancë kohore nga tërheqjet jashtë vendit. Madje, është evidentuar se ka muaj të plotë ku subjekti dhe bashkëshortja nuk kryejnë asnjë tërheqje nga pagat e tyre në bankë⁷³. Në këto kushte, të krijohet bindja se subjekti dhe bashkëshortja kanë teprica të gjendjeve *cash* nga tërheqjet e tyre jashtë vendit, të cilat duket se i përdorin pas kthimit në Shqipëri.

8.1.19 Për të konkluduar në lidhje me pretendimet e subjektit, në vlerësimin e tij përfundimtar, Komisioni çmoi se bazuar në dokumentacionin e administruar, por edhe në kërkimet me qëllim verifikimin e provave dhe deklarimeve të paraqitura nga subjekti me parashtrimet e tij, nuk mund të arrihet në konkluzion nëse veprimet e kryera në pikat e shitjes POS janë pagesa apo tërheqje *cash*. Për këtë arsye, pretendimet e subjektit në lidhje me këtë çështje, pavarësisht se ai ka paraqitur prova dhe dhënë shpjegime për të provuar të kundërtën, nuk mund të merren në konsideratë, pasi pretendimet e tij nuk provohen në mënyrë të plotë dhe bindëse qoftë nga përshkrimi bankar i transaksioneve të kryera, qoftë nga tarifa bankare e paguar për kryerjen e çdo veprimi në POS. Në këto kushte, veprimet me kartën e debitit të subjektit nga Raiffeisen Bank vazhdojnë të mbeten të konsideruara si pagesa/blerje të kryera jashtë shtetit nga ana e subjektit e, për rrjedhojë, mbeten të reflektuara në analizën financiare përfundimtare si një shpenzim ekstra, përtej atyre të jetesës. Ndërsa, sa i takon tërheqjeve të kryera nga ATM jashtë shtetit, në analizën përfundimtare të Komisionit, ato u konsideruan si çdo tërheqje tjetër nga banka, e kryer brenda Shqipërisë, vlera monetare të cilat subjekti i disponon dhe i menaxhon sipas nevojave të tij.

Në lidhje me veprime të kryera nga subjekti në pikat e shitjes POS, apo edhe tërheqje në bankomat jashtë shtetit, Komisioni, marrë shkas se disa nga këto veprime ishin kryer në hotele-kazino, përgjatë hetimit ngriti dyshime se subjekti ishte një frekuentues dhe lojtar në lojëra fati,

⁷³ Në muajt prill 2015 dhe gusht 2015, të dy bashkëshortët nuk kanë tërhequr asnjë vlerë monetare nga llogaritë e tyre bankare; gjithashtu gjatë muajve nëntor - dhjetor 2016 e deri në janar 2017, nuk është kryer asnjë tërheqje brenda vendit, ndërkohë që veprimi i fundit jashtë shtetit është kryer nga subjekti në datën 29.10.2016. Sidoqoftë, viti me numrin më të lartë të udhëtimeve dhe tërheqjeve jashtë vendit, krahasuar me vitet e tjerë, është viti 2015.

çka do të përbente një problem etik për magjistratin në sytë e publikut. Vetë subjekti i rivlerësimit kundërshtoi në mënyrë kategorike pjesëmarrjen e tij në lojëra fati, në seancë dëgjimore.

Në përfundim, për Komisionin, këto dyshime mbetën të paprovuara me dokumente, në mënyrë bindëse, të plotë dhe shteruese, përforcuar kjo edhe me faktin se subjekti nuk ka deklaruar ndër vite qoftë shpenzime apo edhe përfitime nga këto lojëra.

9. Veprime të bashkëshortes B. V. me kartë krediti në Raiffeisen Bank

9.1 Nga verifikimi i lëvizjes së llogarisë bankare të lidhur me kartën e kreditit në Raiffeisen Bank, u evidentua se ajo ka kryer disa veprime/blerje *online*, si dhe pagesa periodike për shlyerjen e detyrimit për shumat e përdorura me kartën e kreditit, të treguara në tabelën e mëposhtme:

Veprimi bankar/vitet	2013	2014	2015	2016	Total në lek
Blerje produkte/shërbimesh <i>online</i> (në lek)	56,505	20,435	125,463	185,031	387,435
Pagesa për kartën e kreditit (në lek)	16,406	46,874	132,177	172,586	368,043

9.2 Për të evidentuar llojin e shpenzimeve, u kryen kërkime në internet bazuar në emërtimin e pikës tregtare ku është përdorur karta⁷⁴, të cilat u ndanë në dy grupe:

- i) pagesa hotelesh, blerje biletash, pagesë për marrje VISA për në Amerikë, të cilat deri në këtë fazë të hetimit u përfshinë tek shpenzimet e udhëtimit sipas sistemit TIMS;
- ii) blerje mallrash konsumi, të cilat nisur nga dyqanet apo markat e produkteve u gjykua se ishin mbi shportën e konsumit të përcaktuar nga INSTAT-i. Për këtë arsye, këto shpenzime, deri në këtë fazë të hetimit, nuk u konsideruan si pjesë e shpenzimeve standarde të jetesës, por si shpenzime përtej atyre.

9.3 Në analizën financiare u përfshinë si shpenzime pagesat e kryera nga bashkëshortja në kartën e kreditit të saj, pasi ky është momenti i realizimit/kryerjes së shpenzimit nga ana e saj⁷⁵.

9.4 Bazuar në të gjitha sa më sipër, pagesat e kryera në kartën e kreditit, të cilat nuk lidhen me shpenzimet e udhëtimit (bileta, akomodim ushqim jashtë shtetit), u përlllogaritën në vlerën **368,043 lekë**⁷⁶.

Kjo vlerë, deri në këtë fazë të hetimit, u përfshi në analizën financiare të viteve përkatëse, si një zë i veçantë në rubrikën e shpenzimeve, përtej atyre të jetesës.

9.5 Nga lëvizja e llogarisë së kartës së kreditit të bashkëshortes, u evidentuan edhe dy veprime blerje biletash avioni, por meqenëse ato nuk u identifikuan se cilit udhëtim i përkasin, u përfshinë në analizën financiare, me rezervë⁷⁷. Ndërsa, dy veprime pagesash që kanë shërbyer për blerje *online* (biletë avioni dhe pagesë hoteli), të cilat janë identifikuar se cilave udhëtime i përkasin⁷⁸,

⁷⁴ Blerjet janë: pagesa hotelesh, blerje biletash, pagesë VISA për në Amerikë, blerje veshmbathjeje, produkte kozmetike, farmaceutike, elektronike, libra dhe në raste të kufizuara, siç janë aeroportet, blerje ushqime të gatshme.

⁷⁵ Në momentin e blerjes së një produkti apo shërbimi, blerësi merr hua nga karta e kreditit. Kështu, shpenzimi dhe huaja (si e ardhur) zerojnë njëra-tjetrën. Momenti i shpenzimit të individit blerës është kur ai paguan detyrimin që ka ndaj bankës për përdorimin e huas/kartës së kreditit. Për këtë arsye, në analizën financiare si shpenzim është përfshirë pagesa ndaj kartës dhe jo blerja e produkteve, të cilat janë 2 veprime të cilat ndodhin në kohë të ndryshme.

⁷⁶ Në këtë vlerë përfshihen edhe komisionet e bankës.

⁷⁷ Shuma 141,000 lekë, si pagesë për blerje në booking.com në datën 26.02.2015 dhe 20,136.09 lekë për blerje në *** në datën 17.3.2016.

⁷⁸ Në datën 17.11.2014, suma 34,215 lekë, paguar biletë me ***; në datën 18.9.2015, suma 34,081 lekë, është paguar akomodim në hotel për subjektin.

janë zbritur nga përlogaritja e pagesave në kartën e kreditit, pasi ato janë përfshirë tek shpenzimet e udhëtimit TIMS.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

9.6 Subjekti ka kundërshtuar analizën e Komisionit, në të cilën janë përfshirë si shpenzime ekstra pagesat e kryera nga bashkëshortja me kartën e kreditit, në vlerën 368,043 lekë.

9.6.1 Nisur nga lloji i tyre, subjekti nënvizon se ato janë mallra konsumi të përditshëm dhe se duhen përfshirë tek shpenzimet e jetesës. Ai i referohet strukturës së shportës së konsumit sipas Anketës së Buxhetit të Familjes (ABF) të kryer nga INSTAT-i, e cila përfshin midis të tjerash veshje, këpucë dhe një sërë zërash të tjerë.

9.6.2 Subjekti kërkon që blerjet e bashkëshortes me kartë krediti për veshje dhe këpucë, deri në nivelin e shportës së përcaktuar nga ABF, duhet të njihen dhe t'i zbriten shumës totale të pagesave me kartë krediti. Subjekti sjell në vëmendje edhe qëndrimin e Kolegjit në raste të ngjashme⁷⁹.

9.6.3 Ai ka kryer disa përlogaritje dhe ka paraqitur pranë Komisionit shpenzimet me kartë krediti të bashkëshortes që, sipas tij, duhet të njihen si zë i veçantë i reduktuar, në analizën financiare për periudhën 2013 – 2016.

9.7 Disa veprime të kryera për të tretë me kartën e kreditit të bashkëshortes në Raiffeisen Bank

Subjekti kërkon që të hiqen nga shpenzimet në analizën financiare vlerat e disa pagesave me kartë, të cilat i ka kryer bashkëshortja e tij për të tretë, dhe konkretisht:

9.7.1 Shuma 141,000 lekë si pagesë për blerje në faqen e internetit *www.booking.com*, në datën 26.2.2015, e cila është përdorur për të prenotuar dhomë hoteli për kolegen e saj E. H., e cila do të shkonte me shërbim nga puna në Berlin. Shuma i është rimbursuar bashkëshortes në *cash* dhe është depozituar prej saj në llogarinë e kartës së kreditit në Raiffeisen Bank në datën 16.3.2015.

Subjekti ka paraqitur me parashtrimet të gjitha dokumentet e koleges E. H., ku tregohen transaksionet e deklaruara prej tij.

9.7.2 Shuma 20,136.09 lekë për blerje në faqen e internetit ***, në datën 17.3.2016, është përdorur për të prerë biletë për nënën e subjektit, e cila nuk ka kartë krediti dhe ia ka dhënë vlerën e biletës subjektit në *cash*. Subjekti ka depozituar prenotimin *online* të biletës së nënës së tij.

9.7.3 Shuma 34,215 lekë, paguar në datën 17.11.2014 për blerje biletë avioni me ***, të cilën Komisioni e ka përfshirë në shpenzimet e udhëtimit TIMS, është përdorur për të prerë biletë për nënën e tij dhe, si e tillë, ajo duhet hequr si shpenzim i bashkëshortes.

9.7.4 Shuma 34.081 lekë, paguar në datën 18.9.2015, përfaqëson një pagesë për Hotel *** në ***, të cilën Komisioni e ka përfshirë në shpenzimet e udhëtimit TIMS, si shpenzim i kryer për subjektin, i cili ka shoqëruar bashkëshorten e tij. Ai sqaron se kjo pagesë është kryer për një udhëtim pune të bashkëshortes dhe një kolegu të saj. Subjekti ka paraqitur komunikimin me *email*

⁷⁹ Vendimi nr. 404, datë 23.6.2021, paragrafi 3.19.23, ku Kolegji ka arsyetuar se: “3.19.23 Në vijim, në analizën financiare të familjes prindërore janë zbritur nga niveli standard i shpenzimeve jetike vlerat e produkteve të cilat sigurohen dhe prodhohen nga familjet rurale nëpërmjet aktivitetit bujqësor dhe blegtoral të tyre, të tilla si qumështi dhe nënproduktet e tij, vezë, mish fruta, perime, drithëra, etj.”.

të bashkëshortes me hotelin dhe kërkon që kjo shumë të zbritet nga shpenzimet TIMS për vitin 2015.

Vlerësimi i Komisionit

9.8 Në lidhje me pretendimin e subjektit për njohjen e blerjeve për produktet veshje dhe këpucë, si pjesë e shpenzimeve të jetesës deri në nivelin e përcaktuar nga INSTAT-i, Komisioni vlerëson se këto shpenzime janë vlera të mesatarizuara, që kanë rezultuar nga shpenzimet e të gjitha shtresave ekonomiko-sociale të vendit. Në këtë kuptim, shporta e konsumit përfaqëson një minimum jetik, i cili shërben për të mbuluar nevojat bazike të çdo personi dhe familjeje. Sa i takon familjes së subjektit, duket se ajo nuk jeton në kushtet e një minimumi jetik, nisur kjo nga transaksionet bankare të evidentuara, udhëtimet e kryera jashtë shtetit, llojet dhe markat e produkteve të blera me kartë, apo nga pikat e shitjes së frekuentuara.

9.9 Për këto arsye, pretendimi i subjektit nuk u mor në konsideratë dhe blerjet e evidentuara me kartën e kreditit të bashkëshortes në Raiffeisen Bank mbeten të përfshira në analizën financiare si një zë më vete, përtej shpenzimeve standarde të jetesës.

9.9.1 Nga shpenzimet me kartën e kreditit të bashkëshortes, Komisioni vlerëson se duhet të zbriten shumat e shpenzuara nga data 3 deri më 6.6.2016, në vlerën 112,854 lekë, të cilat i takojnë udhëtimit në USA, pasi këto shpenzime janë përfshirë në ato të udhëtimeve TIMS. Por, meqenëse vlera e shpenzimeve ekstra për shkak të blerjeve me këtë kartë krediti përbëhet nga pagesat e bashkëshortes për të shlyer detyrimin e kartës, atëherë nga shpenzimet në fjalë do të zbriten të gjitha pagesat e bëra prej saj në llogarinë e kartës, pas datës 6 qershor 2016 deri më 31 dhjetor të këtij viti, të cilat janë në masën 88,435 lekë. Kjo shumë e paguar është destinuar për të mbyllur detyrimin e kartës së kreditit, të krijuar nga blerjet në USA (*shihni trajtimin në çështjen 11.5, në vijim*).

9.10 Në lidhje me katër veprimet e blerjes/pagesës, Komisioni ka vlerësuar si më poshtë vijon:

9.10.1 Sa i takon shumës 141,000 lekë, pagesë për prenotimin e një dhome hoteli, pasi u kryen verifikimet nga Komisioni, rezultoi se kolegja E. H. ka shkuar në *** me urdhër shërbimi nga Agjencia Kombëtare e Turizmit dhe ka qëndruar atje nga data 2 deri në 8 mars; sipas *statement-it* të Raiffeisen Bank, prenotimi është bërë në datën 26.2.2015 me kartën e kreditit të shtetases B. V. dhe pagesa ka kaluar në hotel nga booking.com në datën 27.2.2015; në datën 16.3.2015, në llogarinë e kartës së kreditit të shtetases B. V. është depozituar *cash* prej saj shuma 141,000 lekë.

9.10.2 Sa më sipër, përputhen sqarimet e subjektit me dokumentet e verifikuara, si dhe datat e pagesave dhe shumat. Për këtë arsye, ky pretendim i subjektit u mor në konsideratë nga Komisioni dhe shpenzimi u zbrit nga rubrika e shpenzimeve ekstra të subjektit, në analizën financiare.

9.10.3 Sa i takon shumës 20,136.09 lekë, u verifikua që pagesa e biletës nga karta e kreditit të shtetases B. V. është bërë në datën 17.3.2016 dhe në të njëjtën datë është bërë edhe prerja e biletës në emër të nënës së subjektit, P. V.. Deklarimet e subjektit përputhen me provat e përcjella e, për këtë arsye, ky pretendim u mor në konsideratë nga ana e Komisionit. Ky shpenzim u zbrit nga analiza financiare e subjektit si shpenzim ekstra.

9.10.4 Sa i takon shumës 34.215 lekë, pretenduar se është paguar për biletën e nënës së tij në ***, nga verifikimet rezultoi se shpenzimi në këtë vlerë është bërë me kartën e bashkëshortes në datën 17.11.2014, ndërkohë që bileta e nënës P. V. është prenotuar/blerë 3 javë më vonë, në datën 7.12.2014. Pretendimi i subjektit mbetet i paprovuar e, për këtë arsye, ai nuk u mor në konsideratë në analizën financiare përfundimtare. Ky shpenzim është i përfshirë në shpenzimet TIMS.

9.10.5 Sa i takon shumës 34,081 lekë, paguar në datën 18.9.2015, pretenduar se nuk i takon subjektit, Komisioni kreu verifikimet e nevojshme, nga ku rezultoi se deklaratimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e paraqitur⁸⁰. Për këtë arsye, ky pretendim u mor në konsideratë nga ana e Komisionit. Shuma 34,081 lekë është zbritur nga shpenzimet TIMS, duke marrë të mirëqenë sqarimin logjik të subjektit që ai është akomoduar në të njëjtën dhomë hoteli me bashkëshorten e tij.

10. Veprime të bashkëshortes në llogarinë e pagës tek Tirana Bank

10.1 Nga verifikimi i lëvizjes së llogarisë së pagës të bashkëshortes së subjektit, u evidentuan disa veprime të kryera jashtë shtetit, me kartën e saj të debitit të lidhur me këtë llogari. Ato janë treguar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë:

Veprime me kartën e debitit Tirana Bank	2014	2015	Total në lek
Tërheqje nga ATM (në lek) ⁸¹	210.035	482,534	692.569
Veprime në Pika Shitjesh POS (në lek) ⁸²		20.727	20.727
Total shpenzime	210.035	503.261	713.296

10.2 Bazuar në natyrën e veprimeve, në këtë fazë të hetimit ato u klasifikuan në:

- i) tre veprime/blerje në POS, në vlerën 20,727 lekë, i janë shtuar shpenzimeve standarde TIMS;
- ii) 11 veprime tërheqjeje në ATM u konsideruan si shpenzime ekstra të subjektit dhe bashkëshortes, pasi ato nuk mund të jenë pjesë e shpenzimeve të standardizuara TIMS, të cilat mbulojnë akomodim, bileta dhe ushqim, në vlera bazike. Këto tërheqje *cash* në shumën 703,606 lekë, së bashku me komisionet bankare që iu takojnë këtyre tërheqjeve, u përfshinë në analizën financiare si një zë më vete, në rubrikën e shpenzimeve.

10.3 Subjekti i rivlerësimit nuk ka mbajtur qëndrim për këto shpenzime në mënyrë eksplicite, por qasja e tij sa i takon konsiderimit të tërheqjeve nga ATM jashtë vendit është trajtuar në çështjet

⁸⁰ Kjo shumë është paguar në datën 18.9.2014, me përshkrimin e Hotel *** në ***. Në të njëjtën datë janë bërë 2 pagesa me kartën e kreditit për në Hotel ***: (a) njëra prej 99,000 rreth lekë/rreth 700 euro. Kjo shumë është kredituar mbrapsht nga Hotel *** në datën 28.9.2014 e, për këtë arsye, ajo nuk ishte e përfshirë si shpenzim i subjektit në analizën financiare. Rimbursimi i kësaj shume provohet edhe nga një korrespondencë *email*-i midis shtetasës B. V. dhe Hotel ***, për vlerën 699 euro, paguar nga B. për vete dhe kolegün. Ndërkohë që shuma 34,081 lekë është përsëri pagesë, përveç shumës 700 euro. Nga verifikimi i dokumentacionit të plotë mbi shpenzimet e bashkëshortes për pjesëmarrjen në panair në *** dhe rimbursimin e këtyre shpenzimeve nga Agjencia e Turizmit, u verifikua që kuota e aprovuar dhe e paguar për hotelin për shtetasen B. V. është 1,259 euro. Ky dokumentacion u krahasua edhe me sqarimet dhe dokumentacionin e përcjellë nga subjekti me parashtrimet e tij. Nga kombinimi i informacionit të mësipërm, ka rezultuar se të dyja pagesat e kryera, pra edhe shuma 99,000 lekë (e rimbursuar nga hoteli), por edhe shuma 34,081 lekë/259 euro, në total në shumën 133,759 lekë ose 959 euro, janë të mbuluara nga fondi i akorduar tek shtetasja B. V. për këtë aktivitet, i paguar nga institucioni punëdhënës i saj.

⁸¹ Gjatë vitit 2014 janë kryer 3 tërheqje dhe gjatë vitit 2015 janë kryer 8 tërheqje.

⁸² 3 veprime POS, në datën 9.10.2015, në Maqedoninë e Veriut, nga përshkrimi i subjektit tregtar duken të jenë blerje mallrash konsumi.

8.1.7 - 8.1.9. Sipas tij, tërheqjet nga ATM jashtë Shqipërisë nuk mund të konsiderohen si shpenzim.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

10.4 Sikurse është arsyetuar në çështjet 8.1.15 - 8.1.19 të këtij vendimi, Komisioni ka vlerësuar se pretendimet e subjektit qëndrojnë dhe ato janë marrë në konsideratë në analizën përfundimtare financiare të subjektit.

10.5 Tërheqjet e kryera në ATM jashtë Shqipërisë janë konsideruar si çdo tërheqje tjetër nga banka e subjektit dhe bashkëshortes së tij.

11. Shpenzime TIMS

Shpenzimet e udhëtimit jashtë shtetit janë përlllogaritur bazuar në të dhënat e sistemit TIMS dhe standardit tashmë të konsoliduar të Kolegjit⁸³. Nga këto shpenzime dallohen:

11.1 Shpenzimet e udhëtimit në USA për vitin 2016

➤ Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se për udhëtimin në Amerikë ai ka shpenzuar shumën rreth 322,000 lekë, në të cilën sipas këtij deklarimi përfshihen shpenzimet për VISA plus blerje me kartë krediti për ushqim në aeroport plus bileta avioni. Nga verifikimi i llogarisë mbajtëse të kartës së kreditit të bashkëshortes në Raiffeisen Bank, u evidentua se shpenzimet për VISA në vlerën 400 \$ janë paguar me këtë kartë. Kështu, shpenzimi prej 400 \$, duke qenë i përfshirë në shpenzimet e udhëtimit të lartpërmendura, nuk është përfshirë si shpenzim i bashkëshortes për kartën e saj të kreditit në Raiffeisen Bank.

➤ Gjithashtu, përveç shumës 322,000 lekë si më sipër, është evidentuar se janë kryer disa shpenzime nga llogaritë bankare të subjektit, të lidhura me kartat e debitit dhe kreditit të tij në Raiffeisen Bank. Këto shpenzime janë në vlerën 169,872 lekë, e cila i shtohet shpenzimeve të udhëtimit në vitin 2016.

➤ Meqenëse gjatë udhëtimit të subjektit në *** tek miqtë e tij, janë evidentuar veprime të kryera me kartë krediti të subjektit në ***, do të duhet të shtohen edhe shpenzimet e biletave vajtje-ardhje, nga *** në ***. Nga një kërkim në faqet e internetit të kompanive të ndryshme ajrore, ka rezultuar se çmimi për një biletë vajtje-ardhje për person varion nga 100 deri në 300 \$⁸⁴. Si shpenzim për subjektin dhe bashkëshorten është konsideruar një vlerë mesatare e biletës prej 200 \$ për secilin.

Në total, shpenzimi për udhëtimin në Amerikë, deri në këtë fazë të hetimit, është përlllogaritur në vlerën 535,328 lekë ose 4,004 euro⁸⁵.

11.2 Udhëtimi i bashkëshortes në Itali në korrik 2016. Nga vërtetimi i agjencisë turistike rezulton se në vlerën 170 euro janë të paguara bileta dhe hoteli. Në këtë udhëtim janë shtuar edhe shpenzimet e ushqimit, të cilat janë përlllogaritur 30 euro në ditë.

⁸³ Shihni vendimin nr. 11 (JR), datë 22.5.2019, Kolegji i Posaçëm i Apelit.

⁸⁴ Çmimet e evidentuara janë aktuale, ato nuk marrin parasysh fleksibilitetin e orareve, avancën e kohës kur priten biletat e tjera. Në këtë mënyrë ato konsiderohen si çmime indikative.

⁸⁵ Kursi i këmbimit 1 euro = 135.27 lekë, Banka e Shqipërisë, datë 31.12.2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore ka kundërshtuar analizën financiare të Komisionit, duke parashtruar se:

11.3 Kundërshton përllogaritjet e kryera nga Komisioni në lidhje me shpenzimet në USA, duke sjellë në vëmendje të Komisionit se deklarimi që ai ka bërë në pyetësonin standard përfshin të gjitha shpenzimet që ai ka kryer në USA: *“Komisioni, përveç shumës së deklaruar nga ana ime në vlerën prej 322,000 lekësh, ka dubluar duke përfshirë për herë të dytë shpenzimet e kryera me kartë në shumën prej 169,872 lekësh dhe biletat e udhëtimit nga *** në ***, të cilat ishin përfshirë nga ana ime dhe ishin pjesë e shumës prej 322,000 lekësh. Kur kam deklaruar këtë shumë, kam marrë në konsideratë biletat vajtje-ardhje, kostot e qëndrimit sipas metodologjisë së përdorur nga Kolegji, ashtu edhe pagesat me kartë krediti apo shpenzime të tjera të kryera në USA. Për këtë arsye, shuma prej 322,000 lekësh, e deklaruar si shpenzim nga ana ime, përfshin të gjitha shpenzimet e kryera në USA dhe nuk duhet të rëndohet duke dubluar disa shpenzime, sikurse është vepruar nga Komisioni.*

Në analizën financiare për vitin 2016, shpenzimet TIMS për udhëtimin në USA duhet të përfshihen në shumën 322,000 lekë, sikurse është deklaruar nga ana ime”.

11.4 Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, Komisioni ka rishikuar edhe një herë përllogaritjet e shpenzimeve gjatë udhëtimit në USA, nga ku ka rezultuar se ato janë në vlerën 392,526 lekë⁸⁶.

11.5 Pjesë e shpenzimeve të mësipërme është totali prej 112,854 lekësh i evidentuar në kartën e kreditit të bashkëshortes në Raiffeisen Bank. Për të mos dubluar shpenzimet, shumat e paguara për pagesën e kartës së debitit të bashkëshortes në Raiffeisen Bank, nga data 6.6.2024 deri më 31.12.2016, të cilat janë paguar për të shlyer këto shpenzime, janë zbritur nga shpenzimet ekstra të bashkëshortes. Këto shpenzime janë në vlerën 88,435 lekë.

12. Analiza financiare 2013 – 2016

12.1 Komisioni kreu analizën financiare të subjektit, për periudhën e rivlerësimit, nga emërimi në detyrë dhe deri në datën 31.12.2016. Sipas kësaj analize, deri në këtë fazë të hetimit, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë rezultuar me një balancë negative totale në vlerën 2,088,606 lekë, e përbërë nga shumatorja e balancave negative të vitit 2014, në vlerën -564,643 lekë⁸⁷; viti 2015, në vlerën -1,022,869 lekë⁸⁸; dhe viti 2016, në vlerën -501,095 lekë⁸⁹.

⁸⁶ Blerja e biletave 1,200 \$; kostoja e qëndrimit tek miqtë në *** për 14 ditë, duke përllogaritur 5 \$/ditë; 400 \$ shpenzuar për VISA në Ambasadën Amerikane dhe paguar me kartën e bashkëshortes në Raiffeisen Bank; çmimi i biletave nga *** në ***, sipas standardit 180 \$ për secilin; kostoja e qëndrimit për 3 ditë në *** me standardin 50 \$/ditë; blerjet e kryera me kartën e kreditit të bashkëshortes në Raiffeisen Bank në datat 3 deri 6 qershor 2016, në vlerën 112,854 lekë.

⁸⁷ Të ardhura të dokumentuara 4,490,765 lekë; shpenzime 2,042,540 lekë; pasuri neto 3,012,868 lekë (si diferencë e pasurisë bruto prej 2,408,099 lekë dhe detyrimeve në vlerën negative prej 604,769 lekësh si shlyerje e kredisë).

⁸⁸ Të ardhura të dokumentuara 1,878,953 lekë; shpenzime 3,561,188 lekë; pasuri neto në vlerën negative -659,367 lekë (si diferencë e pasurisë bruto në vlerën negative -1,294,854 lekë, për shkak të pakësimit të likuiditeteve dhe detyrimeve në vlerën negative prej 659,367 lekësh si shlyerje e kredisë).

⁸⁹ Të ardhura të dokumentuara 2,532,617 lekë; shpenzime 2,624,112 lekë; pasuri neto 409,600 lekë (si diferencë e pasurisë bruto prej 12,535,182 lekësh dhe detyrimeve në vlerën 12,125,582 lekë, që përfaqëson marrjen e kredisë tek Raiffeisen Bank).

12.2 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ngarkoi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit në lidhje me konstatimin:

Duket se subjekti dhe familja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurive të tyre dhe mbulimin e të gjitha shpenzimeve, për shkak të një rezultati negativ prej 2,088,606 lekësh (shuma e viteve me balanca negative).

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

12.3 Subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të Komisionit, duke paraqitur një analizë të tijën, për çdo vit të periudhës së rivlerësimit. Përveç prapësimeve të tij për disa shpenzime të përfshira në analizën financiare, të trajtuara hollësisht përgjatë këtij vendimi, subjekti ka kundërshtuar edhe përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit nga shtëpia në punë, duke nënvizuar që këto shpenzime janë pjesë e strukturës së shpenzimeve sipas Anketës së Buxhetit të Familjes dhe nuk duhen konsideruar më vete dhe në një zë të veçantë.

Sipas kësaj analize, duke marrë në konsideratë rishikimet e pretenduara prej tij, subjekti rezulton me balanca pozitive në të gjitha vitet e periudhës 2013 – 2016.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit

12.4 Pasi vlerësoi të gjitha provat dhe argumentimin e subjektit në parashtrimet e tij, si dhe në seancën dëgjimore, Komisioni mori në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, të cilat i reflektoi në analizën financiare. Konkretisht:

- Tërheqjet e kryera nga ATM jashtë shtetit janë hequr si shpenzim ekstra në analizën financiare;
- Disa veprime me kartën e kreditit të bashkëshortes në Raiffeisen Bank, të cilat nuk i takonin subjektit dhe familjes së tij, janë zbritur;
- Janë rishikuar pagesat e bashkëshortes në kartën e kreditit në Raiffeisen Bank për të shmangur dublimin e tyre me shpenzimet TIMS;
- Janë rishikuar shpenzimet e udhëtimit TIMS.

12.5 Në përfundim të procesit të rivlerësimit është kryer analiza financiare përfundimtare, e cila tregon mundësinë e subjektit për të përballuar krijimin e pasurive dhe shpenzimet përgjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën si më poshtë:

Përshkrimi	Nga 28.5.2013	2014	2015	2016
Pasuri	385,943	2,408,099	-1,294,854	12,535,182
Apartament 127.27 m ² , ****, blerë K. 2.5.2016				13,527,000
Blerë automjet Golf 2013, prodhim i vitit 1999, shitur më 16.1.2015	420,630		-420,630	
Automjet Daimler Chrysler ***, blerë më 16.1.2015			344,125	
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	<i>-34,687</i>	<i>2,408,099</i>	<i>-1,218,349</i>	<i>-991,818</i>
Gjendja e likuiditeteve	-34,687	2,373,412	1,155,063	163,244
Detyrimet	-331,264	-604,769	-635,487	12,125,582
Hua nga O. A., akt noterial 2.4.2016				2,029,050
Kredi marrë nga RFZ Bank, kontrata 16.5.2016				11,000,000
<i>Shlyerja e kredisë tek Raiffeisen Bank</i>				<i>-186,537</i>

Shlyerja e kredisë 41,000 euro tek ICB IBC	-331,264	-604,769	-635,487	-716,931
Pasuri neto	717,207	3,012,868	-659,367	409,600
Të ardhura të dokumentuara	1,575,452	4,490,765	1,878,953	2,532,617
Të ardhura të subjektit	634,735	1,312,028	1,229,395	1,166,690
Të ardhura të bashkëshortes nga paga	940,717	478,457	635,958	1,365,927
Ekzekutim vendimi gjyqësor për bashkëshorten		2,700,280		
Të ardhura nga interesa bankarë			13,600	
Shpenzime	621,085	1,884,260	2,807,816	2,297,345
Shpenzime jetese për 4 persona	329,056	879,992	897,104	940,368
Shpenzime udhëtimi TIMS	100,471	262,802	596,936	488,567
Shpenzime udhëtimi nga banesa në punë	26,400	48,400	48,400	48,400
Shlyerja interesash për kredi bankare tek RZB Bank				179,497
Komisione kredie tek RZB Bank				131,999
Shlyerja interesash për kredi bankare tek ICB	125,768	175,751	131,311	31,072
Shpenzime shëndetësore sipas pyetësorit nr. 1	8,413	16,813	19,271	5,411
Humbje nga shitja e automjetit (sistemi veprimi)			76,505	
Veprime jashtë Shqipërisë me kartë (subjekti RZB Bank)	14,571	301,983	535,519	187,879
Pagesa për kartën e kreditit b/sh RZB Bank	16,406	46,874	132,177	84,152
Tërheqje me kartën e debitit b/sh Tirana Bank (vetëm tarifat)		2,444	8,593	
Shpenzime të tjera të deklaruar (pyetësori standard)			250,000	200,000
Pagesa të tjera të evidentuara		149,200	112,000	
Mundësia për kursime	237,159	-406,364	-269,496	-174,328

Nga kjo analizë ka rezultuar se subjekti dhe familja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurive të tyre dhe mbulimin e të gjitha shpenzimeve, për shkak të një rezultati negativ prej 850,187 lekësh (shuma e viteve me balanca negative).

B. KONTROLI I FIGURËS

13. Ish-Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, sot Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) pas kërkesës së Komisionit për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar ka përcjellë⁹⁰ pranë Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit Gëzim Veizi, i deklasifikuar plotësisht⁹¹, dhe nga Grupi i Punës informohet se:

13.1 Për subjektin e rivlerësimit Gëzim Veizi nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Gëzim Veizi*.

13.2 Komisioni konstaton se nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas

⁹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.5.2024.

⁹¹ Me vendim të KDZH-së nr. *** , datë 15.5.2024.

parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, duke konfirmuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Gëzim Veizi.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

14. Rivlerësimi profesional, sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është i bazuar në raportin e përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, dhe kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit. Ky organ ka hartuar raportin vlerësues nr. *** prot., datë 23.5.2023, për subjektin e rivlerësimit Gëzim Veizi.

14.1 Në raportin e Komisionit të Vlerësimit pranë KLP-së, për subjektin e rivlerësimit janë evidentuar: aftësi të mira profesionale; aftësi të mira organizative; aftësi për të kryer procedurat gjyqësore dhe aftësi për të administruar dosjet; etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; aftësitë personale e angazhimi profesional.

14.2 Nga të dhënat e referuara nga KLP-ja ka rezultuar se me vendim të Prokurorit të Përgjithshëm, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “shumë mirë”.

14.3 Komisioni ka administruar përgjigjen e Prokurorisë së Përgjithshme⁹², e cila konfirmon se nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit Gëzim Veizi.

14.4 Prokuroria e Përgjithshme⁹³ ka përcjellë pranë Komisionit informacionin e prokurorive të rretheve gjyqësore⁹⁴, të cilat kanë konfirmuar se pranë tyre nuk rezulton të jenë depozituar kallëzime apo procedime në ngarkim të subjektit Gëzim Veizi.

14.5 Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, po ashtu edhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁹⁵, kanë konfirmuar se pranë tyre janë regjistruar kallëzime penale⁹⁶ ndaj subjektit Gëzim Veizi, por pas verifikimit të tyre është vendosur mosfillimi i procedimit.

⁹² Përgjigja e Drejtorisë së Koordinimit nr. *** prot., datë 15.2.2021.

⁹³ Prokuroria e Përgjithshme, me nr. *** prot., datë 30.3.2021.

⁹⁴ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë, me nr. *** prot., datë 5.3.2021; Kavajë nr. *** prot., datë 10.3.2021; Lezhë nr. *** prot., datë 23.2.2021; Fier nr. *** prot., datë 23.2.2021; Lushnjë nr. *** prot., datë 23.2.2021; Vlorë nr. *** prot., datë 24.2.2021; Dibër nr. *** prot., datë 23.2.2021; Elbasan nr. *** prot., datë 1.3.2021; Sarandë nr. *** prot., datë 23.2.2021; Pogradec nr. *** prot., datë 24.2.2021; Korçë nr. *** prot., datë 26.2.2021; Shkodër nr. *** prot., datë 24.2.2021; Gjirokastrë nr. *** prot., datë 18.2.2021; Kukës nr. *** prot., datë 18.2.2021; Kurbin nr. *** prot., datë 18.2.2021; Pukë nr. *** prot., datë 18.2.2021; Mat nr. *** prot., datë 18.2.2021; Tropojë nr. *** prot., datë 17.2.2021; Berat nr. *** prot., datë 18.2.2021; Përmet nr. *** prot., datë 17.2.2021; Durrës nr. *** prot., datë 17.2.2021.

⁹⁵ Përgjigja e PPKKKO-së nr. *** prot., datë 6.6.2024 dhe e Prokurorisë së Rrethit Tiranë me nr. *** prot., datë 19.2.2021.

⁹⁶ Shihni informacionin në përgjigjet e prokurorive: (a) PPKKKO-ja konfirmon se pranë saj rezulton i regjistruar kallëzimi penal nr. ***/2023 i shtetasit I. H. ndaj subjektit Gëzim Veizi, për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës” në formën e grupit kriminal dhe pas verifikimeve të kryera në lidhje me të është vendosur mosfillim procedimi me datë 18.9.2023. Gjithashtu, në ish-Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda rezulton i regjistruar kallëzimi penal nr. ***/2019 i shtetasës L. P. ndaj disa prokurorëve dhe gjyqtarëve, përfshirë edhe subjektin Gëzim Veizi, për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, ku pas verifikimeve të kryera në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi penal me datë 20.5.2019; (b) Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë konfirmon se pranë saj është regjistruar: (i) Kallëzimi penal nr. ***/2017 i shtetasit V. Ç., i cili ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarëve, ku ndër të tjerë ka përmendur edhe emrin e prokurorit Gëzim Veizi, për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, ku prokurori i çështjes, pasi ka verifikuar aktet, ka vendosur në datën 14.11.2017 mosfillimin e procedimit penal; (ii) Procedimi penal nr. ***/2019, ardhur me shkresën nr. ***/1 prot., datë 22.11.2018, nga Prokuroria e Përgjithshme, mbi bazën e informacionit të Prokurorisë së Apelit Durrës. Në material pretendohet se prokurori Gëzim Veizi së bashku me gjyqtarin kanë ulur dënimin e shtetasit V. Y. Prokurori i çështjes K. H., pasi ka verifikuar aktet, ka kërkuar nga gjykata e shkallës së parë pushimin e procedimit penal, kërkesë kjo e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. *** regj. them., datë 13.5.2019.

14.6 Komisioni analizoi 3 dokumentet ligjore⁹⁷ të paraqitura për vlerësim nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe 4 dokumentet ligjore të përzgjedhura me short (dosjet 2, 3, 4 dhe 5)⁹⁸, ku në përfundim nuk u konstatuan problematika në lidhje me kriterin profesional.

14.7 Në lidhje me dosjen 1, që i referohet “Kallëzimit penal nr. ***/2015 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për mosfillimin e procedimit penal datë 15.7.2015 të bërë nga ILDKPKI-ja ndaj ish-doganierit H. Z.”, Komisioni, ashtu sikurse edhe raporti i KLP-së, konstatoi se: *Vendimi i mosfillimit të procedimit penal është marrë jashtë afatit 30-ditor të parashikuar në udhëzimin nr. ***, datë 19.6.2012 “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. ***, datë 21.11.2005 “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar, i Prokurorit të Përgjithshëm.* Për këtë konstatim, Komisioni bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë prova.

14.8 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ndër të tjera, ka shpjeguar se vendimi i mosfillimit është marrë tej afatit 30-ditor pasi janë kryer veprime verifikuese nga ana e OPGJ-së, të cilat ishin të nevojshme për të përcaktuar faktet objekt kallëzimi. Subjekti sqaron se udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm ishte orientues dhe nuk ishte i detyrueshëm. Gjithashtu, në vitin 2015, vendimet e mosfillimit jo gjithmonë janë marrë brenda afatit 30-ditor, për shkak të ngarkesës në Prokurori⁹⁹.

14.9 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme. Nga informacioni në dosje rezulton se në një shkresë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. ***, datë 2.12.2022, ndaj vendimit të mosfillimit nuk është ushtruar ankim në gjykatë. Gjithashtu, nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti rezulton se dosja e vendimit të pushimit i është nënshtruar edhe kontrollit nga drejtuesi i Prokurorisë, i cili e ka gjetur të drejtë dhe të mbështetur në ligj këtë vendim.

Nuk ka të dhëna nëse ndaj këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka përcjellë aktet e procedimit penal nr. ***/2018 për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pa autor. Nga aktet ka rezultuar se nga drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Durrës me shkresën nr. *** prot., datë 9.11.2018, është dërguar informacioni në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë për shkelje të rënda të ligjit nga prokurori i çështjes Gëzim Veizi dhe gjyqtarët A. B. e A. M. në gjykimin e çështjes penale, me objekt “Rishikimin e vendimit penal nr. ***, datë 24.7.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 15.3.2001, për të cilin është vendosur mospranimi i rekursit nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. ***, datë 28.9.2001”. Komisioni ka administruar përgjigjen e Prokurorisë pranë Gjykatës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila konfirmon se kjo prokurori ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 26.12.2018, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248-25 i Kodit Penal pa emër autori të regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Në datën 10.4.2019, çështja rezulton t’i jetë dërguar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me kërkesë për pushimin e çështjes. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. *** regj. them. datë 13.5.2019, ka vendosur “*Pranimin e kërkesës. Pushimin e procedimit penal nr. ***, regjistruar me datë 26.12.2018 për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal*”. Ndaj këtij vendimi nuk rezultojnë të jetë bërë ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe vendimi ka marrë formë të prerë. Kjo është konfirmuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me anë të email-it datë 28.6.2024.

⁹⁷ 1. Kërkesë “Për gjykimin e çështjes” datë 25.6.2015, përpiluar nga prokurori Gëzim Veizi; 2. Konkluzione përfundimtare në gjykimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2012 të Prokurorisë së Rrethit Durrës; 3. Vendim “Për pushimin e procedimit penal”, procedimi penal nr. ***/2015 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

⁹⁸ Dosja 2. Vendim për pushimin e procedimit penal nr. ***/2013; Dosja 3. Vendim për pushimin e procedimit penal nr. ***/2015; Dosja 4. Kërkesë për gjykimin e çështjes të procedimit penal nr. ***/2013; Dosja 5. Kërkesë për gjykimin e çështjes së procedimit penal nr. ***/2014.

⁹⁹ Subjekti ka depozituar si dokument provues listat me ngarkesat e çështjeve në Prokurorinë e Rrethit Durrës për të gjithë prokurorët.

Komisioni vlerëson se vonesa në marrjen e këtij vendimi tej afatit të përcaktuar në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nuk vlerësohet të ketë një peshë specifike në vlerësimin e subjektit në lidhje me kriterin profesional.

14.10 Nga të dhënat e burimeve arkivore të KLP-së nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit Gëzim Veizi të ketë marrë ndonjë masë disiplinore.

14.11 Rezulton se për periudhën 2006 – 2020 ndaj subjektit Gëzim Veizi janë paraqitur 4 ankesa, ku 3 prej tyre janë analizuar dhe nuk janë evidentuar probleme nga Prokuroria e Përgjithshme¹⁰⁰.

14.12 Komisioni ka analizuar ankesën e shtetasit H. B.¹⁰¹, i cili ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***/2013 të subjektit Gëzim Veizi, ankesë kjo që është pranuar nga Prokuroria e Përgjithshme, duke shfuqizuar vendimin e pushimit të subjektit.

14.12.1 Për të verifikuar pretendimet e ankuesit, Komisioni administroi nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës¹⁰² fashikullin e procedimit penal nr. ***/2013, nga ku rezultoi se në bazë të kallëzimit penal të shtetasit H. B., të datës 20.3.2013, kjo Prokurori regjistroi procedimin penal nr. ***/2013 për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës” të kryer nga punonjës të ZVRPP-së Durrës.

14.12.2 Fillimisht kjo çështje u hetua nga një prokuror tjetër, e më pas i kaloi subjektit Gëzim Veizi, i cili bazuar në veprimet hetimore të kryera nga prokurori i mëparshëm në datën 4.4.2014 vendosi pushimin e çështjes, me argumentin se: *“Nga ish-punonjës të ZVRPP-së Durrës janë kryer veprime në kundërshtim me ligjin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, duke konsumuar elementet e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe duke qenë se kjo vepër dënohet deri në 5 vjet, ndjekja penale është parashkruar. Dokumentet e paraqitura nga shtetasi G. K. janë dokumente që nuk janë falsifikuar në kuptim të dispozitës përkatëse të falsifikimit, por kanë dalë si rezultat i punës së punonjësve të ZVRPP-së Durrës, pasi nuk kanë vepruar në zbatim të ligjit dhe prej tyre është konsumuar vepra penale “Shpërdorimi i detyrës”.*

14.12.3 Drejtuesi i Prokurorisë, në datën 3.11.2014 vendosi shfuqizimin e vendimit të pushimit datë 4.4.2014 të procedimit penal nr. *** të prokurorit Gëzim Veizi dhe vazhdimin e hetimeve, duke caktuar kryerjen e disa veprimeve hetimore. Ndër të tjera, drejtuesi i Prokurorisë ka argumentuar se zgjidhja ligjore e çështjes nuk është e bazuar në ligj dhe në prova: *“(a) hetimi nuk është kryer i plotë; (b) baza ligjore e përdorur për pushimin e çështjes pika “dh” e nenit 328/1 i Kodit të Procedurave Penale nuk i përshtatet arsyetimit të vendimit”.*

14.12.4 Pasi çështja u kthye për hetime të tjera, në dosje rezultojnë të jenë kryer disa veprime hetimore, por jo të gjitha detyrat e caktuara nga drejtuesi i Prokurorisë. Nga subjekti Gëzim Veizi, në datën 9.9.2015 u vendos pushimi i çështjes për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, me të njëjtin argument të përmendur më lart.

¹⁰⁰ 1. Ankesa nr. *** e shtetasit L. P., por nga materiali rezulton se kjo ankesë është drejtuar kundër disa gjyqtarëve dhe prokurorëve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Këtë material Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. *** prot., datë 6.5.2019, e ka dërguar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe në këtë shkresë, si dhe në përmbajtjen e ankesës, nuk përmendet emri i subjektit Gëzim Veizi; 2. Ankesa nr. *** e shtetasit V. Ç., e cila është trajtuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë si kallëzimi nr. ***, përmendur më poshtë vijon; 3. Ankesa nr. *** e shtetasit I. Ç., i cili ankohej kundër një vendim mosfillimi të prokurorit, por pa përmendur shkaqet dhe nuk është pranuar nga Prokuroria e Përgjithshme.

¹⁰¹ Ankesa nr. *** e shtetasit H. B.

¹⁰² Prokuroria e Rrethit Durrës me nr. *** prot, datë 6.6.2024.

14.12.5 Ankuesi H. B. vendimin e pushimit të procedimit penal të datës 9.9.2015 të prokurorit Gëzim Veizi e ankimoi në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila me vendimin e datës 10.12.2015 vendosi shfuqizimin e vendimit të pushimit të mësipërm, duke evidentuar: *“Kryerjen e veprimeve hetimore të tjera; Referenca ligjore, neni 328, germa “dh” e Kodit të Procedurës Penale “se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale ose nuk provohet se e ka kryer ai”, bie në kontradiktë me arsyetimin e vendimit të pushimit; Nga prokuroria nuk janë kryer detyrat e lëna në vendimin e shfuqizimit datë 5.11.2013 të drejtuesit të Prokurorisë Durrës, etj”*.

14.12.6 Pasi çështja u rikthye nga Prokuroria e Përgjithshme për hetime të mëtejshme, subjekti Gëzim Veizi ka kryer veprimet hetimore të lëna si detyrë, por pa plotësuar një të vetme (nuk iu drejtua Gjykatës së Lartë për një kopje dokumentacioni) dhe, në datën 21.11.2016, subjekti pushoi përsëri procedimin në fjalë, duke përdorur bazën ligjore të duhur, atë të shkronjës “d”, paragrafi I i nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale.

14.12.7 Pasi analizoi dokumentacionin e fashikullit penal, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë prova bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për konstatimet se:

✓ *Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime hetimore të plota në përputhje me nenet 24 dhe 304 të Kodit të Procedurës Penale, pasi dy vendimet e pushimit të procedimit datë 4.4.2014 dhe 9.9.2015 iu shfuqizuan nga drejtuesi i Prokurorisë dhe Prokuroria e Përgjithshme.*

✓ *Subjekti i rivlerësimit në dy vendimet e shfuqizuara ka përdorur në mënyrë të gabuar bazën ligjore, shkronjën “dh” të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, që bie në kundërshtim me arsyetimin e vendimit, në një kohë që duhej të kishte përdorur shkronjën “d” të këtij neni.*

✓ *Subjekti i rivlerësimit nuk i ka kryer të gjitha veprimet hetimore të lëna si detyrë në vendimin e shfuqizimit të Prokurorisë së Përgjithshme.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

14.12.8 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ndër të tjera, ka shpjeguar se vendimmarrja përfundimtare e kësaj çështjeje, e datës 21.11.2016, i është komunikuar shtetasit H. B., dhe ky i fundit nuk e ka ankimuar këtë vendim. Pra, rezulton se vendimmarrja e subjektit ka qenë e bazuar në ligj, megjithëse vendimi është shfuqizuar disa herë dhe nuk ka rezultuar në asnjë moment se ndodhej përpara ndonjë veprë tjetër penale dhe procedimi penal ishte dërguar për gjykim. Subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, që konfirmon se ndaj vendimit të Prokurorisë në lidhje me procedimin penal nr. ***/2013 nuk ka ushtruar ankim shtetasi H. B.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

14.12.9 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme. Pas kthimit të çështjes për hetime të mëtejshme, ai ka kryer detyrat e caktuara nga drejtuesi i Prokurorisë dhe Prokuroria e Përgjithshme, por ai duhet të kishte treguar kujdesin e duhur t’i plotësonte të gjitha. Subjekti nuk ka dhënë shpjegime për përdorimin e gabim të bazës ligjore, por ai pranon që vendimet e tij i janë nënshtruar kontrollit të hierarkisë nga prokurorët më të lartë. Në përfundim, Komisioni konstaton se subjekti ka vijuar me mosfillimin e procedimit, duke vendosur bazën ligjore të saktë dhe ky vendim nuk u ankimua më nga ankuesi H. B.

Denoncimet/ankesat nga publiku

15. Për subjektin e rivlerësimit Gëzim Veizi janë depozituar 14 denoncime dhe 1 letër mirënjohjeje nga publiku.

15.1 Komisioni ka analizuar dhe vlerësuar 9¹⁰³ denoncime, ku në disa raste është kërkuar dokumentacioni përkatës, dhe nuk konstatoi elemente që e ngarkonin subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore për sa i përket kriterit profesional.

15.2 Komisioni ka analizuar dhe vlerësuar 5 denoncimet e mëposhtme, për të cilat janë evidentuar problematika dhe janë administruar dokumente, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, apo i janë kërkuar shpjegime.

15.3 Denoncim i shtetasit A. L.¹⁰⁴, i cili pretendon që një kallëzim të bërë prej tij për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, prokurori Gëzim Veizi në datën 21.7.2014 vendosi pushimin e procedimit penal nr. ***/2013 dhe pas ankimit të këtij vendimi nga kallëzuesi në Prokurorinë e Përgjithshme kjo e fundit shfuqizoi këtë vendim pushimi dhe vijimin e hetimeve.

15.3.1 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultoi se Prokuroria e Përgjithshme me vendimin datë 27.7.2015 ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit datë 21.7.2014 të procedimit penal nr. ***/2013, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve të Prokurorisë së Rrethit Durrës, pasi vendimi i pushimit vlerësohet si jo i drejtë dhe pa kryer hetim të plotë dhe të gjithanshëm. Ka rezultuar se nga subjekti Gëzim Veizi janë plotësuar detyrat e lëna nga Prokuroria e Përgjithshme dhe, në datën 23.6.2016, subjekti ka dërguar kërkesën për gjykimin e çështjes penale me të pandehur shtetasin L. Z.

15.3.2 Pasi analizoi dokumentacionin e fashikullit penal, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë prova bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për konstatimin se subjekti i rivlerësimit “*Nuk ka kryer veprime të plota hetimore në përputhje me nenet 24 dhe 304 të Kodit të Procedurës Penale, që e çoi atë në vendimmarrjen e pushimit të çështjes, vendim që iu shfuqizua nga Prokuroria e Përgjithshme*”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

15.3.3 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ndër të tjera, ka shpjeguar se në kushtet kur vendimi është shfuqizuar dhe referuar faktit se organi i akuzës në këtë periudhë kohe ka qenë i centralizuar dhe vendimet e prokurorit më të lartë ishin të detyrueshme për prokurorin më të ulët, subjekti ka vendosur dërgimin e çështjes penale për gjykim, ku prej të dy shkallëve të gjykimit është vendosur sikurse subjekti me vendimin e datës 29.12.2014, pra deklarin e pafajshëm të të pandehurit L. Z. Subjekti ka depozituar vendimet e dy gjykatave, atë

¹⁰³ Denoncim nr. ***, datë 12.12.2017, i shtetasit I. Ç.; denoncim nr. *** prot., datë 3.7.2018, i shtetasit S. B.; denoncimet nr. *** prot., datë 25.3.2019, nr. *** prot., datë 23.12.2019, nr. *** prot., datë 24.12.2019 dhe nr. *** prot., datë 6.1.2020, të shtetasit V. Ç.; denoncimet nr. *** prot., datë 22.9.2021 dhe nr. *** prot., datë 16.9.2021, të shtetas L. A.; letër mirënjohjeje nr. *** prot., datë 8.2.2021, e shtetas L. M.; denoncim nr. *** prot., datë 21.5.2024, i shtetas D. M.

¹⁰⁴ Denoncim nr. *** prot., datë 27.7.2018.

të shkallës së parë dhe të apelit¹⁰⁵, të cilat e kanë deklaruar të pafajshëm shtetasin L. Z., për të cilin subjekti kishte pushuar hetimet herën e parë.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

15.3.4 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme. Në lidhje me vendimin e shfuqizimit, bazuar në pikën 5 të nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet proceduralisht se: *“Prokurori më i lartë ka të drejtë të vendosë ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurori më i ulët me ankim ose kryesisht”*. Pas shfuqizimit të vendimit, është konstatuar se subjekti Gëzim Veizi ka kryer detyrat e caktuara nga Prokuroria e Përgjithshme dhe ka vijuar me kërkesën për gjykim. Komisioni vlerëson se subjekti ka vepruar në përputhje me nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale kur ka kryer veprimet hetimore të përcaktuara në detyrat e lëna nga prokurori më i lartë, por që vendimmarrja e gjykatave të çon në përfundimin se vendimmarrja fillestare e subjektit të rivlerësimit ka qenë e drejtë.

15.4 Dy denoncime të shtetasit I. H.¹⁰⁶ për një kallëzim të bërë prej tij në vitin 2022, hetuar nga prokurori Gëzim Veizi, ku është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Denoncuesi ngre pretendimet se: (i) vendimi nuk i është komunikuar kallëzuesit, duke i mohuar të drejtën e ankimit në gjykatë; (ii) vendimi është i padrejtë, duke i shkaktuar atij dëme të vazhdueshme në banesën e tij si pasojë e veprimeve të paligjshme të shtetasve ngjitur që po bënin një ndërtim.

15.4.1 Komisioni ka administruar fashikullin e procedimit penal nr. ***/2022¹⁰⁷, ku rezulton se në Komisaratin e Policisë Durrës ka bërë kallëzim shtetasi I. H. për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”. Në përfundim të hetimit, prokurori Gëzim Veizi vendosi mosfillimin e çështjes, pasi nga të dhënat rezulton se nuk ndodhemi para ndonjë fakti apo veprë penale. Kallëzuesit I. H. nuk është njoftuar për vendimin e mosfillimit dhe ka ardhur në dijeni rastësisht dhe nga ai moment ai ka ankimuar vendimin e mosfillimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, e cila, pasi shqyrtoi çështjen, me vendimin e datës 9.2.2023 vendosi: *“Pranimin e ankimit të ankuesit I. H. kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal datë 7.4.2022 të Prokurorisë Durrës lidhur me kallëzimin nr. ***/2022 dhe shfuqizimin e këtij vendimi. Urdhërohet prokurori të regjistrojë procedimin penal për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar përkatësisht në nenin 199/a të Kodit Penal, dhe të kryejë hetime të mëtejshme”*.

15.4.2 Subjekti Gëzim Veizi nuk ka qenë dakord me vendimin e gjykatës dhe e ka ankimuar atë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë¹⁰⁸, e cila konfirmon se kjo çështje nuk është gjykuar ende në këtë gjykatë.

15.4.3 Pasi analizoi dokumentacionin e fashikullit penal, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë prova bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për konstatimet:

*i) Vendimi i mosfillimit të procedimit penal i datës 7.4.2022 nuk i është njoftuar kallëzuesit I. H. në përputhje me nenin 291, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale*¹⁰⁹.

¹⁰⁵ Vendimi nr. *** datë 27.6.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe vendimi nr. *** datë 12.7.2017, i Gjykatës së Apelit Durrës.

¹⁰⁶ Denoncimet nr. *** prot., datë 16.12.2022 dhe nr. *** prot., datë 4.1.2023.

¹⁰⁷ Dërguar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës me nr. *** prot., datë 10.6.2024.

¹⁰⁸ Përgjigjja e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. *** prot., datë 20.6.2024.

¹⁰⁹ Vendimi i është njoftuar vetëm Komisaratin të Policisë.

ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer të veprime të plota hetimore në përputhje me nenet 24 dhe 304 të Kodit të Procedurës Penale për të arritur në vendimmarrjen e mosfillimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

15.4.4 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore ka shpjeguar ndër të tjera se shtetasi I. H. nuk ka qenë në cilësinë e kallëzuesit, por çështja është referuar nga OPGJ pranë Komisarariatit të Policisë. Vendimi i mosfillimit është marrë brenda afatit ligjor dhe i është njoftuar komisarariatit meqenëse materiali hetimor ishte referuar prej tij, por pavarësisht se ky shtetas nuk ka marrë vendimin, atij nuk i ka humbur e drejta e ankimit, të cilën e ka ushtruar në momentin që ka marrë dokumentacionin. Subjekti shpjegon më tej se pas marrjes së vendimit dosja dërgohet në sekretari, e cila vijon procedurën e njoftimeve, procedurë për të cilën subjekti nuk është përgjegjës. Gjithsesi, kallëzuesi nuk ka bërë kërkesa të tjera në sekretari në lidhje me këtë kallëzim. Por, në lidhje me vendimin e gjykatës së shkallës së parë, subjekti nuk ka qenë dakord dhe e ka ankimuar këtë vendim në Gjykatën e Apelit, e cila nuk e ka gjykuar ende.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

15.4.5 Komisioni vëren se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme. Në lidhje me njoftimin e vendimit të mosfillimit të procedimit, nga aktet në dosje rezultoi se njoftimi i është bërë Komisarariatit të Policisë, i cili ka referuar edhe materialet kallëzuese, ndërkohë që Komisioni në barrën e provës i është referuar shtetasit I. H. në cilësinë e viktimës, por gjithsesi njoftimi konsiderohet i ezauruar nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti ka shpjeguar që nuk ka qenë dakord me vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e ka ankimuar këtë vendim në Gjykatën e Apelit, e cila nuk e ka gjykuar ende çështjen.

15.4.6 Komisioni vëren se për sa kohë që subjekti e ka ankimuar vendimin e gjykatës që e detyron të kryejë hetime të tjera për çështjen, Komisioni çmon se veprimet e tij i janë nënshtruar bindjes së tij të brendshme, për të cilën mban parasysh nenin 73 të ligjit nr. 96/2016.

15.5 Denoncim i shtetases Sh. R.¹¹⁰, e cila pretendon se prokurori Gëzim Veizi ka favorizuar të kallëzuarin, duke regjistruar veprën penale “Fyerja” duke pushuar çështjen, pasi kjo veprë amnistohet, në një kohë që kallëzimin denoncuesja e kishte bërë për veprën penale “Përndjekja”, e cila nuk amnistohet.

15.5.1 Komisioni administroi fashikullin e procedimit penal nr. *** nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës¹¹¹, nga ku rezultoi se në datën 4.1.2022 shtetasja Sh. R. është paraqitur pranë Komisarariatit të Policisë Durrës, ku ka bërë kallëzim ndaj shtetasit A. K., pasi në mënyrë të përsëritur e ofendon dhe e përndjek në rrjetet sociale që prej muajit nëntor 2021. Në datën 6.1.2022 nga OPGJ e Komisarariatit të Policisë Durrës është mbajtur informacioni për referimin e veprës penale tek prokurori, me kallëzuese Sh. R., për veprën penale “Keqpërdorimi i thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal. Ky material u përcoll në Prokurorinë e Rrethit Durrës në datën 7.1.2022 dhe më 24.1.2022 prokurori Gëzim Veizi vendosi mosfillimin e procedimit penal të kallëzimit nr. ***, me arsyetimin se fakti i referuar përmban elementet e një figure të veprës penale “Fyerja”, parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal.

¹¹⁰ Denoncim i përcjellë nga ONM-ja me nr. *** prot., datë 5.6.2024.

¹¹¹ Përgjigjja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës nr. *** prot., datë 10.6.2024.

15.5.2 Kallëzuesja Sh. R. ka ankimuar vendimin e mosfillimit të prokurorisë, të datës 24.1.2022, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila me vendimin e datës 2.8.2022 vendosi “*Rrëzimin e kërkesës së ankueses Sh. R.*”, me argumentin se prokurori ka vendosur drejt, pasi në rastin konkret në veprimet e shtetasit A. K. nuk konstatohet ana objektive e figurës së veprës penale “Përndjekja”.

15.5.3 Kallëzuesja, vendimin e mësipërm e ka ankimuar në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. ***, datë 7.11.2022, vendosi: “*Ndryshimin e vendimit penal nr. ***, datë 2.8.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke pranuar kërkesën ankimore, shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Durrës, datë 24.1.2022, detyrimin e Prokurorisë së Rrethit Durrës që të regjistrojë procedimin dhe të vazhdojë hetimet në drejtimin e përcaktuar në pjesën arsyetuese të këtij vendimi*”. Gjykata e Apelit ka arsyetuar se, ndryshe nga sa arsyeton prokurori dhe gjykata e shkallës së parë, çmon se faktet e parashtruara nga kallëzuesja parashikohen nga ligji si veprë penale, konkretisht “Përndjekja”, e sanksionuar nga neni 121/a i Kodit Penal.

15.5.4 Në datën 10.1.2023, subjekti ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprat penale “Përndjekja”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal dhe “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal.

15.5.5 Në datën 17.1.2023, subjekti mori vendimin për kryerjen e veprimeve hetimore nga detyrat e lëna në vendimin e Gjykatës së Apelit¹¹². Në datën 14.5.2024, subjekti bën ndarjen e procedimit penal nr. *** për veprën penale “Keqpërdorimi i thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal, duke regjistruar një procedim të ri me nr. ***, datë 14.5.2024, për veprën penale “Përndjekja”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal. Subjekti, në datën 14.5.2024, ka vendosur pushimin e çështjes për veprën penale “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”.

15.5.6 Pasi analizoi dokumentacionin e fashikullit penal, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë prova bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për konstatimet për sa duket se:

- i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime të plota hetimore në përputhje me nenet 24 dhe 304 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat ndikuan edhe në cilësimin juridik të gabuar të veprës penale nga “Përndjekja” në “Fyerja”, për të cilën subjekti vendosi mosfillimin e hetimeve.
- ii) Subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë njoftuar të dëmtuarën Sh. R. për përfundimin e hetimeve, në përputhje me nenin 327 të Kodit të Procedurës Penale.
- iii) Vendimi i mosfillimit të procedimit penal i datës 24.1.2022 rezultoi t’i jetë njoftuar kallëzueses në datën 8.6.2022 (pas 5 muajsh), jashtë afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

15.5.7 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore ka shpjeguar se nga materiali hetimor ai ka çmuar se vepra penale e konsumuar ishte “Fyerja” e parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal dhe jo “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike” e parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal, e referuar nga ana e OPGJ-së. Ky vendim i është komunikuar kallëzueses, e cila

¹¹² Në datën 16.2.2023, OPGJ ka marrë në pyetje shtetasen V. R., motra e kallëzueses, dhe ka këqyruar telefonin e saj; në datën 27.2.2023, OPGJ G. G. ka marrë në pyetje shtetasin A. K. (ose K. Z.); në datën 14.5.2024, nga prokurori Gëzim Veizi njoftohet përfundimi i hetimeve për veprën penale “Keqpërdorimi i thirrjeve telefonike” dhe kjo vepër i nënshtrohet ligjit për amnistinë.

e ankimoi në gjykatë, ku gjykata e shkallës së parë la në fuqi vendimin e subjektit. Më pas, Gjykata e Apelit ka vlerësuar ndryshe faktet dhe ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprat penale “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike” dhe “Përndjekja”. Subjekti thekson se i është nënshtruar bindjes së tij të brendshme, bazuar në aktet e fashikullit hetimor dhe vlerësimit juridik që i ka bërë kallëzimit penal konkret.

15.5.8 Subjekti shpjegon se vendimi është marrë brenda afatit 15-ditor dhe pasi dosjen e ka depozituar në prokurori është detyra e sekretarisë të njoftojë palët. Pra, detyra e subjektit përfundon në momentin që përpilon vendimin dhe e dorëzon në sekretari.

15.5.9 Për mosnjoftimin e të dëmtuarës për përfundimin e hetimeve, subjekti sqaron se pasi ka regjistruar procedimin për veprat penale “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike” dhe “Përndjekja” ka hyrë në fuqi ligji “Për dhënie amnistie”, ku në nenin 6/1 të tij parashikohej se amnistohet ndjekja penale në lidhje me kundërvajtjet penale të kryera deri në datën 31.3.2024, ku bënte pjesë edhe kundërvajtja penale “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, e parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal. Në këto kushte, në datën 14.5.2024, subjekti ka vendosur ndarjen e procedimit penal për kundërvajtjen penale të parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal, ndërkohë që hetimet vazhdojnë për veprën penale “Përndjekja”.

15.5.10 Për mosnjoftimin e viktimës për përfundimin e hetimeve, subjekti shpjegon se neni 328 i Kodit të Procedurës Penale “Pushimi i akuzës”, në pikën 2 ka parashikuar se për kategorinë e kundërvajtjeve penale, ku pushimi i procedimit penal është atribut i prokurorit, nuk ka akt procedural përfundim hetimesh, por vendimi i pushimit është akti procedural që e zëvendëson njoftimin e përfundimit të hetimeve, me të cilin njëri nga subjektet procedurale që parashikon dispozita ka të drejtë të njihet me aktet, të marrë kopje dhe të bëjë ankim në gjykatë.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

15.5.11 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme. Në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale, subjekti ka vepruar bazuar në veprimet hetimore dhe udhëhequr nga bindja e tij të brendshme, për të cilën Komisioni mban parasysh nenin 73 të ligjit nr. 96/2016. Subjekti, sapo është vënë në dijeni për vendimin e Gjykatës së Apelit, ka vijuar me regjistrimin e procedimit penal të përndjekjes, duke plotësuar detyrat e lëna nga kjo gjykatë.

15.5.12 Për njoftimin e vendimit jashtë afatit 10-ditor, subjekti duhet të tregonte kujdesin e duhur që dosja dhe vendimi të depozitoheshin në sekretari brenda 15 ditëve dhe se më tej është detyra e sekretarisë të bëjë njoftimin.

15.5.13 Për mosnjoftimin e përfundimit të hetimeve të viktimës dhe palëve të tjera, ndryshe nga sa interpreton subjekti se nuk ka një akt procedural për përfundim hetimesh dhe se vendimi i pushimit është akti procedural që zëvendëson njoftimin e përfundimit të hetimeve, Komisioni vëren se neni 327 i Kodit të Procedurës Penale e ka parashikuar shprehimisht njoftimin e përfundimit të hetimeve. Komisioni vlerëson se këto konstatime nuk kanë peshë specifike, por se ato do të mbahen në konsideratë në vlerësimin tërësor të subjektit në lidhje me kriterin profesional.

15.6 Denoncim i shtetasit Z. Gj.¹¹³, i cili pretendon se prokurori Gëzim Veizi ka kryer veprime korruptive për dy procedime penale të hetuara prej tij, si vijon:

15.6.1 Në lidhje me procedimin penal nr. * në ngarkim të shtetasit J. Xh.**, denoncuesi pretendon se prokurori Gëzim Veizi ka regjistruar procedimin penal për veprat penale “Vrasja në rrethana cilësuese”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, në ngarkim të këtij shtetasi dhe caktohet masë sigurimi “Arrest në burg” në mungesë dhe shpallet në kërkim kombëtar dhe ndërkombëtar. Në përfundim, prokurori Gëzim Veizi mori ryshfet dhe i pushon akuzën shtetasit J. Xh. për vrasje në rrethana cilësuese dhe e dërgon në gjykim vetëm për veprën “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”. Prokurori ka ndërhyrë edhe në gjykatë që të pranohej kërkesa e tij për dënimin me kusht të shtetasit J. Xh., dhe gjykata vendos sipas kërkesës së prokurorit.

15.6.2 Komisioni, në lidhje me pretendimet e ngritura në denoncim, administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës¹¹⁴ fashikullin penal të këtij procedimi.

15.6.3 Rezulton se në datën 2.9.2019 nga Komisariati i Policisë Durrës është referuar në Prokurori materiali për veprat penale “Vrasja me dashje e mbetur në tentativë” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, duke shpallur në kërkim si të dyshuar shtetasin J. Xh. Nga OPGJ pranë këtij komisariati janë kryer veprimet hetimore, si pyetja e personave që kanë pasur dijeni për ngjarjen¹¹⁵, ekspertim balistik dhe këqyrje e vendit të ngjarjes, si dhe janë verifikuar edhe tabulatet telefonike të personit të dyshuar që ka kryer veprën penale. Subjekti, në datën 2.9.2019, ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprat penale “Vrasja me dashje e mbetur në tentativë” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga nenet 76-22 e 278/1 të Kodit Penal, duke regjistruar emrin e shtetasit J. Xh. si person që i atribuohen këto dy vepra penale. Në datën 17.9.2019, subjekti i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për vlerësim arresti dhe caktim mase sigurimi “Arrest në burg” në mungesë, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

15.6.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 18.9.2019, ka pranuar kërkesën e prokurorisë, duke caktuar masën e sigurisë “Arrest në burg” në mungesë për shtetasin nën hetim J. Xh., i akuzuar për veprat penale “Vrasja me dashje e mbetur në tentativë” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”. Në datën 15.2.2020, subjekti ka njoftuar akuzën dhe ka marrë të pandehur shtetasin J. Xh., duke e akuzuar për veprat penale si më lart dhe, në datën 3.6.2020, subjekti i drejtohet gjykatës me kërkesë për gjykim të pandehurit J. Xh., për veprat e lartpërmendura.

15.6.5 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin e datës 22.9.2020¹¹⁶ ka vendosur kthimin e akteve të Prokurorisë dhe vazhdimin e hetimeve në ngarkim të të pandehurit J. Xh., akuzuar për

¹¹³ Denoncim nr. ***, datë 18.10.2023, i përcjellë nga IMO.

¹¹⁴ Përgjigjja e Prokurorisë pranë Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës nr. *** prot., datë 5.8.2024.

¹¹⁵ Janë pyetur shtetasit H. M, Flo. M., Fat. M., A. Q., G. S., Ble. Xh., Ba. Xh.

¹¹⁶ Vendimi nr. regj. them ***,

dy veprat penale si më lart. Pas vendimit të gjykatës, prokurori ka kryer disa hetime të tjera shtesë, duke ripyetur shtetasit H. M., F. M. e G. S., por nuk ka ripyetur të gjithë personat¹¹⁷.

15.6.6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 12.3.2021¹¹⁸ ka rigjykuar çështjen penale me të pandehur J. Xh., me objekt dërgimin e çështjes në gjykim në ngarkim të të pandehurit J. Xh., akuzuar për veprat penale “Kanosja” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga nenet 76-22 e 278/1 të Kodit Penal.

15.6.7 Gjykata, pasi dëgjoi palët dhe pasi verifikoi aktet e fashikullit, ka konstatuar se hetimet nuk janë të plota dhe se ato duhet të plotësohen. Pas plotësimit të akteve nga prokurori, gjykata, në bazë të nenit 332/d, pika 3, konstatoi se cilësimi juridik i faktit është i gabuar dhe akuza nuk është formuluar në mënyrë të qartë dhe ftoi prokurorin të bëjë ndryshimin dhe saktësimin. Prokurori veproi duke formuluar akuzën e re, duke ia komunikuar atë edhe të pandehurit.

15.6.8 Në përfundim, gjykata vendosi: *“1. Pranimin e kërkesës së prokurorit; Dërgimin e çështjes penale nr. *** në gjykim në ngarkim të të pandehurit J. Xh., i akuzuar për kryerjen e veprave penale “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal.*

15.6.9 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës (gjyqtari V. S. i gjykimit në themel) ka gjykuar në themel çështjen, me kërkuar Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, përfaqësuar nga prokurori Gëzim Veizi, i pandehur J. Xh., viktimë H. M., me objekt gjykimin në themel të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit J. Xh., akuzuar për veprat penale “Kanosja” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga nenet 84 dhe 278/1 të Kodit Penal. Në përfundim të gjykimit, prokurori Gëzim Veizi kërkoi: *“1. Deklarimin fajtor të të pandehurit J. Xh. për veprën penale “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim. 2. Deklarimin fajtor të të pandehurit J. Xh. për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vite burgim. 3. Në zbatim të nenit 55 të Kodit të Procedurës Penale bashkimin e dënimeve dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim. 4. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit t’i ulet 1/3 e dënimit dhe të dënohet përfundimisht me 3 vjet e 4 muaj burgim. 5. Bazuar në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për një afat 3 vjet. Arma e sekuestruar të kalojë në favor të shtetit”.*

15.6.10 Gjykata, me vendimin e datës 10.12.2021¹¹⁹, vendosi: *“1. Deklarimin fajtor të të pandehurit J. Xh. për veprën penale “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim. 2. Deklarimin fajtor të të pandehurit J. Xh. për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burg. 3. Në zbatim të nenit 55 të Kodit të Procedurës Penale bashkimin e dënimeve dhe dënimin e tij me 1 vit burg. 4. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit t’i ulet 1/3 e dënimit dhe të dënohet përfundimisht me 8 muaj burgim. 5. Bazuar në nenin 63 të Kodit të Procedurës Penale pezullimin e ekzekutimit të dënimit*

¹¹⁷ Nuk është pyetur shtetasja M. (pa mbiemër), e specifikuar në detyrat e lëna nga gjykata në vendimin e saj.

¹¹⁸ Vendimi nr. regj. them ***.

¹¹⁹ Vendimi nr. ***

me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i pandehuri të kryejë punë në interes publik pranë Bashkisë Durrës për një periudhë prej 40 orësh etj.”. Gjykata, në individualizimin e dënimit, do të marrë parasysh: (a) faktin që i pandehuri J. Xh. nuk ka qenë i dënuar më parë; (b) moshën 20-vjeçare që i pandehuri kishte në momentin e kryerjes së veprës penale; (c) faktin që marrëdhëniet midis dy familjeve janë normalizuar, gjë që provohet me deklaratimet e dhëna përpara OPGJ-së, por edhe me deklaratën noteriale nr. ***, datë 8.2.2021, të shtetasve F. e H. M. e B. Xh.; (ç) faktin që i pandehuri ka qenë nxënës që ka mbaruar arsimin e mesëm me rezultate të mira. Vendimi mori formë të prerë, pasi nuk u ankimua nga palët.

15.6.11 Pasi analizoi dokumentacionin e fashikullit penal, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë prova bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për konstatimet për sa duket se:

- i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer detyrat e plota për plotësimin e hetimeve të lëna në vendimin e Gjykatës së datës 22.9.2020, në përputhje me nenin 329/b të Kodit të Procedurës Penale.*
- ii) Subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar cilësimin e veprës penale nga “Vrasja me dashje e mbetur në tentativë” në “Kanosja” në mënyrë të paqartë dhe jo bindëse, pa u mbështetur në prova dhe fakte konkrete.*
- iii) Duket se subjekti nuk ka ankimuar vendimin e gjykatës së themelit, që ka vendosur ndryshe nga kërkesa e prokurorit për sa i përket marzhit të dënimit, në përputhje me nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale.*
- iv) Subjekti të shpjegojë se si u gjet arma me të cilën është kryer vepra penale, kur në asnjë akt të fashikullit penal nuk përmendet se si u sekuestrua dhe kujt iu sekuestrua ajo.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

15.6.12 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore ka shpjeguar ndër të tjera¹²⁰ se në lidhje me pyetjen e shtetas M. nuk u bë e mundur, pasi kjo shtetase nuk u arrit të gjendej nga OPGJ, por nga pyetja e shtetasve të tjerë u provua se personi që kishte qëlluar ishte shtetasi J. Xh. dhe pyetja e saj ishte e panevojshme.

15.6.13 Për faktin se si u ndryshua cilësimi i veprës penale, subjekti ka shpjeguar se nga prokuroria ishin kryer më parë veprimet e lëna nga gjykata dhe duke qenë se hetimi ishte i plotë dhe i gjithanshëm, në zbatim edhe të vendimit të gjykatës, u procedua me saktësimin e akuzës, duke formuluar akuzën e re sipas këtij vendimi të gjykatës. Në përfundim, gjykata me vendimin nr. ***, datë 12.3.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq ndaj të pandehurit J. Xh., akuzuar për veprat penale “Kanosja” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve shpërthyesë dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 84 dhe 278/1 të Kodit Penal. Subjekti shpjegon më tej se ndryshimi i akuzës është gjetur i drejtë nga gjykimi i çështjes në themel me vendimin nr. ***, datë 10.12.2021, duke e gjetur fajtor të pandehurin J. Xh. për veprat penale “Kanosja” dhe “Prodhimi dhe mbajtja e armëve shpërthyesë dhe i municionit”.

¹²⁰ Shihni me detaje prapësimet e subjektit në dosje.

15.6.14 Në ndryshimin e akuzës, subjekti shpjegon se ky vendim i është dorëzuar gjykatës në fazën e seancës paraprake në origjinal dhe, për këtë arsye, nuk ndodhet në fashikullin e prokurorit. Konkluzionet përfundimtare subjekti i ka paraqitur me gojë përpara gjykatës.

15.6.15 Në lidhje me mosankimin e vendimit të gjykatës, referuar marzhit të dënimit, subjekti sqaron se prej tij është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vënë të pandehurin në periudhë prove, ndërkohë që edhe gjykata ka aplikuar po pezullimin e vendimit me burgim dhe detyrimin për të kryer punë në shërbim publik. Subjekti sqaron se të dyja këto masa dënimi janë masa dënimi alternativ dhe janë pothuaj të të njëjtit karakter, pasi janë parashikuar në kapitullin “Alternativat e dënimit”.

15.6.16 Në lidhje me armën e sekuestruar që kalon në favor të shtetit, subjekti ka shpjeguar se ky është një gabim material dhe duhet të jetë lapsus, pasi, siç ka konstatuar edhe Komisioni, nuk ka asnjë sekuestrim të ndonjë arme për faktin e ndodhur.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

15.6.17 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme. Në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, pas kthimit të çështjes për hetime të mëtejshme, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar kujdesin e duhur që në dosje të kishte lënë një kopje të vendimit të marrë prej tij për ndryshimin e cilësimit të veprës penale, pasi një kopje ai e kishte dorëzuar në gjykatë. Meqenëse gjyqtari në vendimin e gjykatës të datës 22.9.2020 (nga gjyqtari E. K.) nuk e kishte parashikuar shprehimisht që subjekti krahas hetimeve të tjera shtesë të bënte edhe ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, ky fakt ishte i pasqyruar në vendimin e dytë të seancës paraprake të datës 12.3.2021 nga po i njëjti gjyqtar, në të cilin gjykata, përfundimisht, duke u bazuar në nenin 332/d, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, konstatoi se cilësimi juridik i faktit nga organi i akuzës është i gabuar dhe akuza nuk është formuluar në mënyrë të qartë. Gjykata ftoi prokurorin të bëjë ndryshimin dhe saktësimin, i cili veproi duke formuluar akuzën e re, pasi ia komunikoi atë edhe të pandehurit. Në përfundim, gjykata vendosi të pranonte kërkesën e prokurorit për të dërguar në gjykim të pandehurin J. Xh. për veprën penale të kanosjes etj.

15.6.18 Komisioni vëren se pas vendimit të dytë të gjyqtarit të seancës paraprake, kërkesa e subjektit të rivlerësimit për veprën penale “Kanosja” është pranuar edhe nga gjyqtari i gjykimit të themelit. Komisioni çmon se në lidhje me pasaktësitë e konstatuara në këtë dosje, ato nuk kanë peshë specifike, por merren parasysh në vlerësimin tërësor të kriterit profesional.

15.6.19 Në lidhje me procedimin penal nr. *** në ngarkim të shtetasit E. K., akuzuar për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, denoncuesi pretendon se prokurori Gëzim Veizi ka hetuar edhe çështjen e shtetasit E. K. (i njohur në Durrës me emrin M. Ç.), pjesëtar i një grupi të rrezikshëm kriminal, i cili arrestohet nga policia e Durrësit për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. Pasi kapet me armë të llojit pistoletë, lirohet nga Prokuroria e Rrethit Durrës, edhe pse ishte pjesëtar i një grupi të rrezikshëm kriminal, i dënuar edhe dy herë të tjera më parë. Prokurori Gëzim Veizi pasi mori rryshfet kërkon dënimin e tij me kusht. Më pas, ky shtetas vritet në një atentat në Durrës nga grupi kriminal.

15.6.20 Në lidhje me pretendimet e ngritura në denoncim, Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës¹²¹ fashikullin penal të këtij procedimi, nga ku rezultoi se në datën 24.9.2020 Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës ka referuar aktet e veprës penale në Prokurorinë e Rrethit Durrës, pasi gjatë kontrollit nga punonjësit e policisë shtetasit E. K., që ndodhej në lëvizje me një motor me një shtetas tjetër, rezultoi se në çantën e supit iu gjet një armë zjarri pistoletë me fishek në fole. U bë ndalimi i këtij shtetasi dhe pas një kontrolli të kryer në banesën e tij iu gjet edhe një kuti me 50 copë fishekë. Pas kryerjes së aktit të ekspertimit rezultoi se arma ishte e rregullt dhe realizonte qitje. Në datën 25.9.2020, prokurorja R. H. regjistron procedimin penal dhe emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit” dhe emrin e personit nën hetim E. K. me masë sigurie “Arrest në shtëpi”. Në datën 13.10.2020, prokurorja R. H. zëvendësohet me subjektin e rivlerësimit.

15.6.21 Në datën 11.11.2020, prokurori Gëzim Veizi ka marrë me cilësinë e të pandehurit shtetasin E. K., duke e akuzuar për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, ndërsa në datën 20.11.2020 prokurori i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq të çështjes penale nr. ***. Në konkluzionet përfundimtare drejtuar Gjykatës, subjekti Gëzim Veizi ka kërkuar: *“1.deklarimin fajtor të të pandehurit E. K. (i dënuar më parë), duke e akuzuar për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit” dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim; 2. deklarimin fajtor të të pandehurit E. K. (i dënuar më parë), duke e akuzuar për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit” dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim; 3. Bazuar në nenin 55 të Kodit të Procedurës Penale caktimin e tij me 5 vjet burgim; 4. Bazuar në nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale t’i ulet 1/3 e dënimit, duke e dënuar të pandehurin me 3 vjet e 4 muaj burgim; 5. Bazuar në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale të pezullohet ekzekutimi me burgim për një periudhë 3-vjeçare, me detyrimin për t’u paraqitur tek shërbimi i provës dhe të mos kryejë vepër tjetër penale dhe të mos shoqërohet me persona të dënuar. Arma dhe fishekët e sekuestruar të kalojnë në favor të shtetit”.*

15.6.22 Me vendimin e datës 13.1.2021, nga gjyqtari i seancës paraprake P. Ç. është pranuar kërkesa e prokurorisë për dërgimin në gjyq të çështjes penale, që i përket procedimit penal nr. *** në ngarkim të të pandehurit E. K., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”. Në datën 9.3.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës (gjyqtari i themelit E. K.) ka gjykuar çështjen penale me të pandehur E. K., i akuzuar për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1/2 i Kodit Penal. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, prokurori Gëzim Veizi kërkoi sipas kërkesës për gjykim, si dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës 1 herë në muaj.

15.6.23 Në përfundim, gjykata vendosi sipas kërimit të prokurorit. Vendimi mori formë të prerë, pasi nuk u ankimua.

15.6.24 Pasi analizoi dokumentacionin e fashikullit penal, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë prova bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për konstatimin se:

¹²¹ Përgjigjja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës nr. *** prot., datë 5.8.2024.

Subjekti duket se ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 të Kodit Penal kur ka aplikuar pezullimin e dënimit me burgim, duke i lehtësuar pozitën të të pandehurit me precedentë të rrezikshëm kriminalë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

15.7 Subjekti në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore ka shpjeguar se nga prokurori i mëparshëm është vendosur masa e sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, pasi ky person ka pasur probleme shëndetësore kardiale dhe Covid-19, dhe ndodhej i shtruar në spital. Më pas, në datën 20.11.2020, janë përfunduar hetimet dhe është dërguar çështja për gjykim. Në përfundim të gjykimit, nga subjekti është kërkuar deklarimi fajtor i të pandehurit E. K. dhe në fund është aplikuar neni 59 i Kodit Penal, pasi për këtë shtetas subjekti sqaron se janë mbajtur parasysh rrethanat lehtësuese të marra në konsideratë edhe nga gjykata, siç janë pasqyruar dhe konstatuar edhe nga Komisioni¹²². Gjithashtu, ka qenë edhe fakti se në kohën e gjykimit ishin ende masat e rrepta të zhvillimit të gjykimeve për shkak të pandemisë Covid-19, fakt për të cilin ky i pandehur ishte në masën e sigurimit “Arrest në shtëpi” dhe jo në masën Arrest në burg”. Subjekti gjithashtu ka referuar edhe vendime të Gjykatës së Apelit, në raste të ngjashme dhe analoge si rastin në fjalë, ku janë dhënë vendime bazuar në nenin 59 të Kodit Penal¹²³.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

15.8 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me konstatimin e Komisionit, por ai duhet të kishte sqaruar në lidhje me dënimin e mëparshëm që ky i pandehur kishte pasur. Pra subjekti duhet të shpjegonte nëse i pandehuri ishte dënuar për të njëjtën vepër penale (pra ishte përsëritës), apo ishte i dënuar për një vepër tjetër penale. Kjo “pjesë” ka mbetur e pasqaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit, element që mund të ndikonte në vendimmarrjen e tij ndaj të pandehurit.

15.9 Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit, në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, analizoi rrethanat lehtësuese, që u analizuan edhe nga gjykata në gjykimin në themel, e cila vijoi me vendimmarrje të njëjtë me atë të subjektit.

15.10 Komisioni, në caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi” dhe jo “Arrest në burg” për të pandehurin nga ana e subjektit të rivlerësimit, mban parasysh edhe udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. ***, datë 19.3.2020, ku është propozuar mbajtja në konsideratë e aplikimit të dënimeve alternative të dënimit me burgim për parandalimin e përhapjes së virusit të Covid-19 në fazën e hetimeve paraprake, për vlerësimin e kërkesave për caktimin e masave të sigurimit personal, po ashtu edhe në fazën e diskutimeve përfundimtare në gjykimet e themelit.

15.11 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar kujdesin e duhur në sqarimin e rrethanave të çështjes, që të arrinte në një vendimmarrje të caktuar, por kjo “pakujdesi” do të mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit profesional.

¹²² Faktin që i pandehuri E. K. ka mbajtur një qëndrim pohues ndaj veprës penale; Faktin se i pandehuri ka shfaqur pendesë të thellë për veprimin e kryer; Faktin se i pandehuri nuk i është shmangur procedimit penal si në fazën e hetimeve dhe gjatë gjykimit; Faktin se i pandehuri është hetuar dhe gjykuar me masën e sigurimit “Arrest në shtëpi” prej datës 26.9.2020; Faktin se i pandehuri është në gjendje të rënduar shëndetësore dhe faktin që i pandehuri është babai i dy fëmijëve të mitur.

¹²³ Shihni vendimet e referuar nga subjekti, depozituar bashkë me prapësimet në dosje.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Gëzim Veizi:

i) Ka kryer në tërësi deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka përgjithësisht burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurive.

Komisioni vlerëson se pamundësia financiare në shumën prej **850,187 lekësh, përveç faktit se ajo rezulton e shpërndarë në periudhën 2014 – 2016**, në bazë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, në përputhje edhe me standardet e vendosura nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit¹²⁴, nuk arrin deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin e pasurisë.

ii) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

iii) Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Për këto arsye,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, me shumicë votash,

Vendos:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gëzim Veizi, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

¹²⁴ Referojuni vendimeve nr. 31/2020 (JR) dhe nr. 18/2021 (JR) të Kolegjit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 11.10.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare (Kundër)

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj